

***Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për
Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri***

Analizë e rezultateve të PVNN-së 2000-2012

Qershor 2014



WORLD BANK GROUP

Njësia për Sektorin e Arsimit
Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore

Përmbajtja

Falënderime	iv
Shkurtime dhe akronime	v
Përmbledhje ekzekutive.....	vi
1. Pse është PVNN i rëndësishëm? Vështrim i përgjithshëm i performancës së Shqipërisë në PVNN.....	1
2. Cilësia e dobët dhe pabarazitë e vazhdueshme.....	6
<i>Pabarazitë në Shqipëri: Cilët nxënës mbetin mbrapa?</i>	8
Pabarazitë gjinore	10
Pabarazitë urbane-rurale	11
Shkollat publike dhe private	12
Diaspora shqiptare.....	12
Rëndësia e të mësuarit nga bashkëmoshatarët	13
Politikat e fëmijërisë së hershme.....	15
<i>Si ndikojnë praktikatat në nivel klase tek të mësuarit?</i>	15
Aftësitë matematikore në PVNN 2012.....	16
Aftësitë e leximit në PVNN 2009.....	19
Praktikat e mësimdhënies dhe strategjitë e të mësuarit në lexim	22
3. Rekomandime	24
Referenca	27
Shtojcë	29

Kutitë

Kutia 1. Sistemi arsimor i Shqipërisë	2
Kutia 2. Indeksi PVNN pr statusin ekonomik, social dhe kulturor dhe vlefshmëria e të dhënave PVNN në Shqipëri	7
Kutia 3. Shembull i problemave matematikore nga PVNN 2012: Cilën makinë?	17
Kutia 4. Shembull pyetje nga leximi nga PVNN 2009: Fuqia punëtore	20

Figurat

Figura 1. Rezultatet e PVNN-së dhe PPB për frymë	3
Figura 2. Shpërndarja e nxënësve sipas nivelit të aftësive në matematikë: (a) progresi i Shqipërisë nga 2000 në 2012; (b) Shqipëria dhe vendet krahasuese në 2012; (c) evolucioni i rezultateve të matematikës në Shqipëri nga viti 2000 në vitin 2012	5
Figura 3. Rezultatet PVNN 2012 të Shqipërisë dhe të vendeve krahasuese kundrejt mesatareve të EAQ-së dhe OBZHE-së	6
Figura 4. Shpërndarja e rezultateve të leximit PVNN në Shqipëri dhe në OBZHE	8

Figura 5. Indeksi i mundësive të barabarta: Shqipëria dhe vendet e tjera të EAQ-së, 2009	9
Figura 6. Performanca e nxënësve në matematikë dhe në lexim në PVNN 2000 dhe 2009 sipas grupeve socio-ekonomike	10
Figura 7. Diferenca gjinore në lexim, PVNN 2009, vende të përzgjedhura	11
Figura 8. Performanca e PVNN 2009 në diasporën shqiptare	13
Figura 9. Indeksi i shtresëzimit të shkollave në vendet pjesëmarrëse në PVNN, 2009	14
Figura 10. Përbajtja matematikore në kategoritë e procesit në PVNN	18
Figura 11. Performanca në PVNN 2012 në elementët e ndryshëm matematikorë krahasuar me performancën mesatare të secilit grup	19
Figura 12. Performanca PVNN 2012 në elementët e ndryshëm të leximit krahasuar me performancën mesatare të secilit grup	22
Figura 13. Zbërthimi i diferencave në performancën e leximit ndërmjet fshatrave/qyteteve dhe qyteteve të mëdha (PVNN 2009)	23

Tabela

Tabela 1. Performanca e Shqipërisë në PVNN sipas, 2000-2012	3
Tabela 2. Diferenca në performancë në PVNN 2009 ndërmjet grupeve të quintile sipërme dhe të poshtme socio-ekonomike në Shqipëri	10
Tabela 3. Karakteristikat e nxënësve sipas llojit të shkollave në vitin 2009	12

Falënderime

Ky raport u përgatit nga Lucas Gortazar dhe Daniel Kutner (Sektori i Arsimit, Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore, Banka Botërore), me mbështetjen e Flora Kelmendi (Sektori i Arsimit, Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore, Banka Botërore), Martin Morenos (Konsulent) dhe me redaktimin e Amy Gautam (Konsulente). Ky raport është pjesë e asistencës teknike dhënë Qeverisë së Shqipërisë nën drejtimin e Keiko Inoue (Specialiste e Lartë për Arsimin, Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore, Banka Botërore). Raporti është studimi i tretë i serisë për vendet ku zbatohet PVNN realizuar nga Njësia e Arsimit në Rajonin e Europës dhe Azisë Qendrore të Bankës Botërore. Ekipi shpreh mirënjohje të thellë ndaj Alberto Rodriguez, Andrea Guedes, Cristian Aedo, Omar Arias, dhe Shagun Mehrotra për orientimet, komentet dhe asistencën e tyre të dobishme. Maria Ramirez dhe Soren Nellemann bënë oponencën e raportit. Së fundmi, ekipi dëshiron të shprehë falenderime për kontributin e drejtorit artistik Nicholas Dehaney.

Shkurtime dhe akronime

SESK	Statusi Ekonomik Social dhe Kulturor
EAQ	Europa dhe Azia Qendrore
PPB	Prodhimi i Përgjithshëm Bruto
AMSJ	Anketimi për Matjen e Standardeve të Jetesës
SKA	Strategjia Kombëtare e Arsimit
OBZHE	Organizata pwr Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OLS	Ordinary least squares
PSNL	Progresi në Studimin Ndërkombëtar për Leximin
PVNN	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
TSNMS	Tendencat në Studimin Ndërkombëtar të Matematikës dhe Shkencës
KB	Kombet e Bashkuara
OKBASHK	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën

Përmbledhje ekzekutive

Nxënësit shqiptarë kanë përmirësuar performancën e tyre në PVNN¹ në leximi, matematikë dhe shkenca ndërmjet vitit 2002 dhe vitit 2012, një periudhë kohore gjatë së cilës aksesimi në arsimin e mesëm u rrit shumë. Përmirësimet janë ekuivalente me një çerek deri në gjysëm viti mësimor në matematikë dhe shkencë dhe me më shumë se një vit arsimor në lexim. Përmirësimet u realizuan pavarësisht rritjeve të mëdha në regjistrim dhe ndryshimit të pjesëmarrësve në kampionët e PVNN-së. Përqindja bruto e regjistrimit në arsimin e mesëm ishte vetëm rreth 40 përqind në vitin 2000 por ajo u rrit në mënyrë domethënëse në 72 përqind në vitin 2009 dhe në 83 përqind në vitin 2012. Rritja e madhe në regjistrime zakonisht rezultoi në performancë më të ulët nga nxënësit për shkak të përfshirjes së nxënësve më të varfër që tradicionalisht nuk janë përfshirë. Në kontekstin e një sistemi arsimor që po zgjerohet shpejt është për t'u shënuar që Shqipëria arriti të përmirësojë mesataren e saj të rezultateve të PVNN-së. Bie në sy akoma më tepër që përmirësimi u arrit si pasojë e përparimeve domethënëse të arritura nga nxënës me rezultate të ulëta.

Rezultatet e përmirësuar PVNN të Shqipërisë përkojnë me ndërmarrjen e përpjekjeve intensive për reformim në sektorin e saj të arsimit. Qeveria e Shqipërisë nisi procesin e hartimit të strategjisë për sektorin e arsimit në vitin 2002 që rezultoi në miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin (SKA) në vitin 2004 dhe në përpjekjen e parë për të zhvilluar një plan afatgjatë për sektorin. SKA shërbeu si katalizator për një sërë reformash duke përfshirë këtu përmirësimin e rekrutimit të mësuesve, pagave, menaxhimit; rishikimin e kurrikulave për arsimin nëntëvjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm; transparencë dhe llogaridhënie më e madhe përmes reformës së Maturës, vlerësimit kombëtar të nxënësve; çmime më të ulëta dhe cilësi më të mirë të teksteve shkollore përmes një procesi prokurimi të reformuar; dhe sigurimin e subvencioneve për tekstet shkollore për familjet më të varfra. Ndërsa është përtej objektivit të këtij raporti përcaktimi i marrëdhënies shkak-pasojë ndërmjet gamës së reformave të politikave dhe rezultateve të përmirësuar të procesit PVNN, ky raport tregon se efekti i variablave arsimore nuk mund të ndahet nga efekti i variablave socio-ekonomike. Gjithashtu, duke qene se rritja ekonomike ka qenë mesatarisht 4.9 përqind gjatë 2000-2012, një shpjegim i mundshëm është se përmirësimi në kushtet ekonomike ka ndihmuar që të rritet niveli i gjithë treguesve socialë duke përfshirë këtu edhe performancën e PVNN-së.

Pjesa e nxënësve që arritën të paktën nivelin bazë pati një rritje të moderuar nga 2000-2012. Performanca e nxënësve me rezultate të ulëta është përmirësuar që nga viti 2000 duke rezultuar në rritjen e pjesës së nxënësve që arrijnë nivelin minimal. Në lexim, pjesa e nxënësve që dolën nën 'nivelin funksional të njohurive bazë' u zvogëlua nga 57 përqind në 52 përqind ndërmjet viteve 2000 dhe 2012 dhe nga 64 përqind në 61 përqind në matematikë gjatë së njëjtës periudhë. Gjithsesi, kjo ende do të thotë se shumica e nxënësve nuk janë në gjendje të kuptojnë apo të analizojnë tekste të thjeshta apo të zgjidhin problema të thjeshta matematikore.

Pavarësisht tendencës në rritje, performanca e përgjithshme e Shqipërisë mbetet e ulët. Rezultatet PVNN 2012 të Shqipërisë janë më të ulëta në gjithë Europën dhe Azinë Qendrore (EAQ) dhe ndër më të ulëta nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse në PVNN. Në përgjithësi, Shqipëria është rreth një vit shkollor mbrapa vendeve si Bullgaria, Rumania dhe Serbia dhe rreth dy vjet e gjysëm shkollorë (rreth

¹ Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (ne anglisht PISA (Programme for International Student Assessment))

100 pikë PVNN) pas mesatares së OBZHE-së. Cilësia e arsimit jo vetëm që ka qenë e qëndrueshme por edhe është përmirësuar gjatë zgjerimit dramatik të sistemit arsimor në Shqipëri vitet e fundit por analiza tregon se të rinjtë që në të ardhmen e afërt do të hyjnë në tregun e punës mund të mos i kenë aftësitë e duhura për të plotësuar kërkesat e një ekonomie moderne e cila bazohet tek njohuritë.

Analiza e faktorëve përcaktues të rezultateve PVNN 2012 u pengua nga të dhëna të pasakta në nivel nxënësish të cilat kufizuan analizën tek të dhënat PVNN 2009. Sipas OECD-së, rezultatet konkluduan se Standardet Teknike të PVNN-së u përmbushën plotësisht nga të gjitha vendet dhe ekonomitë që morën pjesë në PVNN 2012 me përjashtim të Shqipërisë. P.sh. Shqipëria paraqiti të dhëna për punësimin e prindërve të cilat ishin të paplota dhe dukeshin të pasakta duke qenë se ishte mbipërdorur një gamë e ngushtë profesionesh. Nuk ishte e mundur që këto probleme të zgjidheshin gjatë pastrimit të të dhënave dhe si rezultat as të dhënat për punësimin e prindërve dhe as indekse që varen nga ato të dhëna (si Indeksi i Statusit Ekonomik, Social dhe Kulturor) nuk u përfshinë në të dhënat ndërkombëtare. Për shkak të vlefshmërisë së ulët të të dhënave për nxënësit në PVNN 2012 ky studim mbështetet kryesisht tek anketimi PVNN 2009 për analizën e karakteristikave të familjeve.

Pabarazi domethënëse vihen re ndërmjet grupeve të nxënësve por asnjëri prej tyre nuk performon mirë duke çuar kështu në konkluzionin se cilësia e arsimit është e dobët në gjithë vendin. Ka prova për dallime të mëdha ndërmjet grupeve me status të ndryshëm socio-ekonomikë, vendndodhje të ndryshme gjeografike, gjini të ndryshme, etj (p.sh. vajzat kanë performancë shumë më të mirë sesa djemtë). Gjithsesi asnjëri prej grupeve nuk krahasohet pozitivisht me standardet e OBZHE-së: p.sh. një nxënës shqiptar me performancë 80% në rezultatet e PVNN -së për leximin do të renditej vetëm në vendin e 45-të në mes të nxënësve nga vende të OBZHE-së. Megjithëse nxënësit në shkolla private dalin shumë më mirë sesa ata në shkollat publike, kjo diferencë shpjegohet plotësisht nga dallimet në karakteristikat socio-ekonomike (të cilat nuk janë subjekt modifikimi përmes reformës së politikave) dhe aksesit ndaj burimeve shkollore më të mira (duke përfshirë mësuesit e kualifikuar). Çdo shkollë mund të bëjë shumë më tepër për të përmirësuar rezultatet e nxënësve dhe për t'i ngritur ato nga ky nivel i ulët.

Në nivelin e sistemit, shtresëzimi shoqëror dhe arsimit parashkollor përbëjnë sfida të mëdha. Një analizë e hollësishme ofron dy konkluzione interesante. Së pari, pavarësisht faktit se Shqipëria është relativisht homogjene për sa i përket statusit socio-ekonomik të banorëve, shtresëzimi social i shkollave (homogjeniteti i shkollave për sa i përket statusit socio-ekonomik) është aq i lartë sa kjo është shqetësuese duke bërë që Shqipëria të ketë sistemin arsimor ndër më të shtresëzuarit krahasuar me vendet e tjera pjesëmarrëse në PVNN. Së dyti, sipas analizës, edhe pse frekuentimi i institucioneve parashkollore në vendet e OBZHE-së ka një ndikim pozitiv në rezultatet e PVNN-së (edhe pas kontrollit për disa faktorë), ky efekt nuk ekziston në Shqipëri. Një shpjegim i mundshëm është që cilësia e institucioneve parashkollore është shumë më e ulët në Shqipëri. Një analizë që e trajton këtë më në hollësi do të ishte e dobishme por ajo del jashtë objektit të këtij studimi.

Analiza e aftësive “për elementët” e matematikës dhe leximit PVNN tregon variacion të lartë në performancë. PVNN e fokuson vlerësimin e hollësishëm të aftësive në lëndë të ndryshme çdo herë që realizohet. Në vitet që u realizua në Shqipëri, 2000 dhe 2009 PVNN u përqendrua tek leximi dhe në vitin 2012 u përqendrua tek matematika, ndërsa PVNN 2015 do të përqendrohet tek shkenca. Krahasuar me performancën mesatare të matematikës dhe të leximit rezultatet në Shqipëri tregojnë

variacion më të lartë përmes vlerësimeve të elementëve sesa në vendet e OBZHE-së. Nxënësit patën rezultate më të mira në problemet për hapësirën dhe formën dhe jo aq të mira në problemet që lidheshin me të dhëna dhe statistika ose me ndryshimin e marrëdhënieve. Në lexim, nxënësit dolën më mirë me tekstet më tradicionale sesa në ushtrimet që kishin të bënin me tekste që përmbaheshin në lista kampionesh, grafikë apo diagrama. Për më tepër, nxënësit shqiptarë nuk kanë rezultate të mira kur është fjala për të lidhur informacionin e paraqitur në një tekst ose një problem matematikor me përvojat e tyre personale.

Praktikat e ndjekura në klasa tregojnë një cilësi të ulët të strategjive të mësimdhënies dhe të mësuarit në Shqipëri krahasuar me vendet e tjera të OBZHE-së dhe EAQ-së. PVNN 2009 ofroi mundësinë që të vlerësohet se cilat lloj strategjish të të mësuarit (memorizim, përpunim, kontroll ose përmbledhje) përdoren më shumë nga nxënësit dhe cilat lloje praktikash të mësimdhënies (disiplina, menaxhimi i klasës, ose aftësia për të angazhuar nxënësit) përdoren tipikisht nga mësuesit. Analiza identifikoi se këta faktorë luajnë një rol domethënës në përcaktimin e rezultateve të të mësuarit si dhe identifikoi rëndësinë e pasjes së mësuesve që kanë të paktën arsim të lartë.

Nga ky studim dalin rekomandimet e mëposhtme për politika:

- 1. Të arrihet konsensus në nivel kombëtar për përmirësimin e cilësisë së arsimit në përgjithësi.** Arritjet e nxënësve të matura nga PVNN u përmirësuan nga viti 2000 në vitin 2012, sidomos në lexim. Gjithësesi, performanca mbetet e ulët dhe shumica e nxënësve kanë rezultate që janë nën nivelin bazë si në lexim ashtu edhe në matematikë. Pavarësisht disa përpjekjeve reformuese gjatë dekadës së kaluar, alokimi i burimeve për arsimin mbetet i pamjaftueshëm dhe ka pak shpresa për rritjen e shpenzimeve publike në kontekstin e kufizimeve fiskale në planin makro. Në planin afatshkurtër, qeveria ballafaqohet me sfidën për të vazhduar përmirësimin e cilësisë së arsimit ndërsa kërkon të fitojë nga efikasiteti në sektor. Në planin afatmesëm-afatgjatë është e qartë se duhen reforma tërësore dhe të koordinuara për të përshpejtuar progresin në sektor, duke filluar me konsensus në nivel kombëtar për të vendosur si prioritet përmirësimin e objektivave mësimore dhe sigurimin e zhvillimit të aftësive për të gjithë. Në rast se nuk pranohet që reforma arsimore paraqet një mundësi unike për të prodhuar një bërthamë punonjësish me aftësi të përshtatshme dhe fleksibël, zhvillimi katalitik ekonomik dhe social nuk do të mund të arrihen në Shqipëri.
- 2. Të drejtohen burimet arsimore dhe mësuesit e kualifikuar në një mënyrë të tillë që të përfitojnë nxënësit që janë në kushte më të këqija.** Disa grupe mbesin mbrapa sistematikisht. Tendanca më shqetësuese është rritja e dallimit ndërmjet nxënësve në kuantilet më të larta dhe më të ulëta të Indeksit SESK të OBZHE-së nga viti 2000 në vitin 2009 duke rezultuar kështu në një diferencë në performancë e cila është ekuivalente me përreth dy vite shkollare si në matematikë, ashtu edhe në lexim. Gjithashtu, diferenca ndërmjet djemve dhe vajzave është më shumë se 60 pikë në lexim, ndërsa diferenca urbane-rurale është më shumë se 50 pikë e cila është ekuivalente me afërsisht një vit e gjysëm shkollor. Edhe pse i gjithë sektori arsimor është i kufizuar nga burimet, më shumë fonde duhet të kenë si fokus djemtë, nxënësit me prejardhje të varfër/disavantazuar., dhe ata që jetojnë në zonat rurale. Shkollave rurale mund t'u nevojiten më shumë burime për shkollat për të zvogëluar diferencën në mjediset socio-ekonomike të nxënësve dhe duhet të ketë stimuj për të siguruar që mësuesit më të mirë të merren me nxënësit më të vështirë. Në lidhje me këtë, ekzistenca e zonave mbivendosura për shkollat dhe

numri në rritje i shkollave të vogla paraqet mundësi për të konsideruar opsionet për rindarjen e zonave të shkollave në një mënyrë të tillë që t'i bëjë shkollat më pak të shtresëzuara dhe të promovojë rezultate më të barabarta.

3. **Të rritet efektiviteti i praktikave të mësuesve pasi kjo është forca kyçe për arritjen e cilësisë.** Analiza thekson rëndësinë e praktikave efektive të mësimdhënies, strategjive të të mësuarit nga nxënësit (pjesërisht produkt e praktikave të mësimdhënies), dhe ndikimin pozitiv kur ka një pjesë të madhe mësuesish të kualifikuar nëpër shkolla. Programet për këshillimin dhe mbështetjen nga kolegët së bashku me vëzhgimet në klasë, zhvillimin profesional të mësuesve të përqendruar tek përmirësimi i efektivitetit në klasë dhe sistemet e reagimit për mësuesit mund të bëjnë dallimin për përforsimin e teknikave të menaxhimit të klasës dhe për të promovuar teknikat përkatëse pedagogjike.
4. **Të zgjerohet mbulimi dhe të monitorohet cilësia e arsimit parashkollor.** Arsimit parashkollor ka potencialin që të zbusë pabarazitë herët në jetë dhe të krijojë kushte të barabarta që në fillim për nxënësit e varfër/disadvantaged. Të dhënat e PVNN-së tregojnë së fillimi i hershëm i shkollës fillore ka një lidhje të fortë me rezultatet e larta të leximit në Shqipëri edhe pas kontrollit të disa faktorëve. Por analiza e variancës për aksesin në arsimin parashkollor ose fillimi i arsimit fillor në moshën gjashtë vjeçare paraqet pabarazi përgjatë kuantilave socio-ekonomike sikurse edhe ndërmjet djemve dhe vajzave. Në kontekstin kur qeveria po konsideron futjen e klasës 0 në arsimin e detyruar, do të nevojiten përpjekje të posaçme për të siguruar që djemtë dhe nxënësit me status të ulët socio-ekonomik të jenë objekt i regjistrimeve. Gjithashtu, cilësia e arsimit të hershëm në Shqipëri duhet të përforsohet dhe të monitorohet për të siguruar që në Shqipëri të arrihet “efekti i arsimit parashkollor”.
5. **Të përmirësohet forca e të dhënave, besueshmëria dhe aksesit tek to.** Sipas OBZHE-së Shqipëria është i vetmi vend të dhënat për familjet e të cilat për PVNN 2012 nuk janë të besueshme. Ndërsa Shqipëria përgatitet për të marrë pjesë tek PVNN 2015, duke përfshirë edhe përdorimin pilot të instrumenteve para pranverës së vitit 2015, është kritike që të ketë mekanizma për të siguruar cilësinë e mbledhjes së të dhënave në mënyrë që politikat të mbështeten në prova. Anketimet ndërkombëtare si PVNN mund të jenë të kushtueshme por ato kanë potencialin për të ndihmuar politikëbërësit që të identifikojnë dobësitë në sektorin e arsimit dhe prandaj ato duhet të shfrytëzohen në maksimum.

1. Pse është PVNN i rëndësishëm? Vështrim i përgjithshëm i performancës së Shqipërisë në PVNN

Arsimi dhe aftësitë janë kritike për zhvillimin si të vendeve ashtu edhe të individëve. Provat ndërkombëtare sugjerojnë se cilësia e arsimit është një nga faktorët më të rëndësishëm përcaktues të rritjes ekonomike afatgjatë.² Hanushek dhe Woessmann (2007 dhe 2012) studiuuan një gamë të gjerë anketimesh për vlerësimin e nxënësve prej vitit 1960 e më vonë duke përfshirë edhe Tendencat në Studimin Ndërkombëtar të Matematikës dhe Shkencës (TSNMS), Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PVNN) dhe Progresin në Studimin Ndërkombëtar të Shkrimit e Leximit (PSNSL). Ata vlerësuan se një përmirësim prej 50 pikësh në rezultatet e PVNN-së do të nënkuptonte një rritje prej 1 përqind në rritjen vjetore të PBB-së për frymë.³ Sistemet arsimore të cilësisë më të lartë kanë të bëjnë edhe me qeveri demokratike. Përtej rritjes ekonomike, arsimi përmirëson standardet e jetesës së individëve pasi ata që janë më të arsimuarit janë në gjendje të fitojnë aftësi më të shumta dhe më cilësore, të cilat i bëjnë ata më produktivë dhe më të punësueshëm duke zgjeruar pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës përgjatë jetës së tyre, gjë që nga ana e saj çon në fitime më të mëdha dhe cilësi më të mirë jete. Shkollimi formal kontribuon gjithashtu edhe në zhvillimin e aftësive socio-emocionale si vëmendja, motivimi, vetëbesimi dhe shëndeti fizik dhe mendor, të cilat të gjitha janë faktorë përcaktues të aftësisë për të kaluar nga një shtresë socio-ekonomike tek tjetra. Individët e pajisur me më shumë arsim dhe aftësi janë më të përgatitur për t'u angazhuar në planin civil, përmirësojnë kapitalin demokratik të vendit të tyre dhe krijojnë mundësi e i shfrytëzojnë ato. Arsimimi është përbërësi kyç për të reduktuar pabarazinë dhe për të rritur mirëqenien e përbashkët. Analiza e të dhënave të hollësishme është kritike për të kuptuar faktorët përcaktues të cilësisë së arsimit dhe mund të luajë një rol të rëndësishëm për t'i dhënë trajtë politikave arsimore të mbështetura në prova. Baza e të dhënave e PVNN-së është një burim shumë i madh në kuadrin e kësaj analize.

PVNN është një instrument për të matur cilësinë e arsimit përmes vendeve. E prezantuar në vitin 2000 nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Europian (OBZHE), PVNN është një studim mbarëbotëror i performancës së nxënësve 15-vjeçarë në tre disiplina të ndryshme: matematikë, shkencë, dhe lexim. PVNN përqendrohet tek kapaciteti dhe aftësia e nxënësve për të trajtuar probleme jetësore reale në ato tre disiplina dhe thekson aftësitë që janë kritike për zhvillimin personal dhe profesional të individëve. PVNN vlerëson vetëm nxënës të cilët janë në sistemin arsimor duke u bërë kështu vlerësimi më realist i disponueshëm për sistemin arsimor të një vendi. Gjithsesi, nëse niveli i lënies së shkollës është i lartë, rezultatet mund të mos përfaqësojnë gjithë 15-vjeçarët e vendit. Sistemi i pikëve i PVNN-së është i standardizuar në mënyrë që rezultati mesatar për çdo disiplinë mes vendeve të OBZHE në vitin 2000 është 500 pikë, me një devijim standard prej 100 pikësh. Sipas OBZHE, 40 pikë në PVNN janë të barazvlerëshme me atë që nxënësit mësojnë gjatë një viti shkollor.⁴ Sistemi arsimor i Shqipërisë (shihni Kutia 1) u vlerësua në raundet e PVNN-së në vitet 2000, 2009, dhe 2012. Pjesëmarrja e Shqipërisë në PVNN na lejon që ta përdorim si

² Shihni Sala-i-Martin, Doppelhofer, and Miller (2004).

³ Shihni Hanushek and Woessmann (2007) and Hanushek (2010). Duke përdorur këto teste si matës të aftësive njohëse të popullsisë, ata tregojnë se vendet që në vitet 1960-të kishin cilësi më të mirë arsimit përjetuan një rritje më të madhe ekonomike gjatë viteve 1960-2000, duke kontrolluar faktorët e tjerë.

⁴ OBZHE (2012a).

“benchmark” në lidhje me vendet e tjera, të masim se deri në çfarë shkalle vendi ka pasur sukses në promovimin e cilësisë së arsimit dhe të përcaktojmë nëse pabarazitë e sistemit janë reduktuar me kalimin e kohës.

Raportet e Bankës Botërore për PVNN e vendeve kërkojnë të eksplorojnë informacionin e shumtë të mbledhur nga PVNN për të analizuar sistemet arsimore dhe për t’u dhënë politikëbërësve alternativa për reformë politikash të mbështetur në prova. Për shkak të fokusit tek politikat Raportet për vendet synojnë të trajtojnë sfidat kyçe në vendet e Europës dhe të Azisë Qendrore (EAQ) duke u fokusuar tek përmirësimi i cilësisë dhe barazisë së arsimit. Analiza në këtë raport përfshin një seksion përshkruar në të cilin diskutohet performanca e nënpopullsive të ndryshme, e ndjekur kjo nga një seksion që identifikon faktorët përcaktues të rezultateve të PVNN-së. Ky seksion ndahet në diskutime mbi rolet e: (i) faktorët socio-ekonomikë dhe të sfondit familjar dhe (ii) faktorë që ndikohen shumë nga politika duke përfshirë këtu ndjekjen, disponueshmërinë e burimeve, efektivitetin e mësuesve (e vëzhguar nëpërmjet praktikave dhe strategjive mësimore të mësuesve), autonominë dhe llogaridhënien e shkollës dhe arsimin parashkollor.⁵ Kuadri standard i Raportit të Vendit ka fleksibilitet të mjaftueshëm që t’i lejojë secilit raport të reflektojë kontekstin specifik të vendit.

Kutia 1. Sistemi arsimor i Shqipërisë

Shqipëria ka një popullsi prej 2.8 milionë shumica dërrmuese e të cilëve janë të etnisë shqiptare. Grupe të tjera etnike përfshijnë romët, grekët dhe maqedonasit. Sistemi arsimor aktualisht i shërben 630, 000 nxënësve në arsimin para-universitar (duke përfshirë arsimin parashkollor). Popullsia me moshë shkollore është në rënie në Shqipëri. Në vitin 2007 kishte 700, 000 nxënës para-universitarë. Gjithashtu, KB parashikojnë se popullsia e grupmoshës 19 vjeç e më e re do të reduktohet nga 32 përqind e popullsisë totale në vitin 2010 në 24 përqind në vitin 2025.


Sistemi arsimor i Shqipërisë konsiston në: (i) arsimin parashkollor për fëmijët me moshë 3-6 vjeç, i cili është falas por nuk është i detyrueshëm; (ii) arsimin fillor të detyrueshëm për fëmijët e moshës 6-15 vjeç i cili ka dy cikle – një cikël më të ulët nga klasa 1-5 dhe cikël më të lartë nga klasa 6-9; (iii) arsim i mesëm i përgjithshëm (zgjat tre vjet) dhe dy nivele të arsimit profesional (që zgjasin tre dhe pesë vjet) - të gjithë ata që diplomohen kanë të drejtë t’i nënshtrohen provimit për t’u pranuar në arsimin e lartë; (iv) arsimit i lartë që ofron cikël të shkurtër studimesh profesionale që zgjasin dy vjet; dhe (v) programe tre vjeçare bachelor, programe dy vjeçare master dhe programe doktoraturash që zgjasin tre ose më shumë vjet. Arsimit është i detyrueshëm deri në fund të klasës së 9-të. Në fund, në përfundim të shkollës së mesme, nxënësit i nënshtrohen provimit të maturës rezultatet e të cilit përdoren si provim mbyllës i arsimit të mesëm dhe si provim pranimit për në universitet. Të gjitha nivelet e arsimit ofrohen si nga institucione shtetërore, ashtu edhe nga institucione private.

Burimi: Banka Botërore (e ardhshme).

Performanca e Shqipërisë në kuadrin e PVNN-së është pak më e ulët se ajo që duhet të pritët duke pasur parasysh nivelin aktual të zhvillimit ekonomik. (Figura 1). P.sh. vendet krahasuese si Tailanda dhe Serbia kanë dalë më mirë në matematikë në PVNN 2012 pavarësisht se kanë nivele të ngjashme

⁵ Shihni Hanushek dhe Woessmann (2010) për një shqyrtim të hollësishëm të analizës së testeve ndërkombëtare si PVNN dhe TSNMS.

të PPB-së për frymë. Nga ana tjetër, performanca e Shqipërisë është në nivelin e pritur kur konsiderohen shpenzimet e saj publike për arsimin për nxënës. Megjithatë është e rëndësishme që të theksohet se shpenzimet publike të Shqipërisë për arsimin janë të ulëta, 3% e PPB-së nivel ky që është mjaft më i ulët sesa ai i vendeve të tjera me strukturë demografike dhe me nivel zhvillimi ekonomik të ngjashme. Gjithsesi, ndërsa është e rëndësishme që të ketë një nivel të caktuar burimesh financiare për të siguruar një standard minimal cilësie, nivele më të larta shpenzimesh dhe zhvillimi nuk japin domosdoshmërisht rezultate më të mira mësimore. Në vende me të ardhura të ulëta-mesatare si Shqipëria më shumë investim mund të ndihmojë që të përmirësohet cilësia por nevojitet më shumë punë për politikën për të realizuar përfitime nga efikasiteti dhe për të arritur përmirësime të qëndrueshme në rezultatet mësimore.



Burimi: PVNN 2012 dhe UNESCO 2012.
 Shënim: Kurba përfaqëson një përaftrim logaritmik të grafikut.

Performanca e Shqipërisë në PVNN 2012 përfaqëson një përmirësim të vogël në lexim dhe shkencë dhe një përmirësim të madh në matematikë (Tabela 1). Që prej vitit 2000 nxënësit shqiptarë kanë bërë progres domethënës në lexim (sidomos ndërmjet viteve 2000 dhe 2009) pjesërisht sepse performanca e tyre në këtë disiplinë ishte më e ulët sesa ajo në matematikë dhe shkencë gjatë raundit të parë. Performanca në matematikë dhe shkencë është përmirësuar por jo me të njëjtin hap që është parë tek leximi. Ndërsa tendenca tregon zhvillime pozitive që prej vitit 2000, Shqipëria filloi nga një bazë shumë e ulët dhe ka ende jashtëzakonisht shumë vend për përmirësim.

Tabela 1. Performanca e Shqipërisë në PVNN sipas disiplinave, 2000-2012

	2000	2009	2012
Lexim	349	385 (+36*)	394 (+9)
Matematikë	381	377 (-4)	394 (+17*)
Shkencë	376	391 (+15*)	397 (+6)

Burimi: PVNN 2000, 2009, dhe 2012.

*Shënim: Ndryshimi i rezultatit në krahasim me raundet e mëparëshme është në kllapa, me një * që tregon rëndësinë statistikore.*

Përmirësimet ndërmjet vitit 2000 dhe vitit 2012 u arritën pavarësisht rritjes së madhe në regjistrime dhe ndryshimeve të pjesëmarrësve në kampionët e PVNN-së. Në vitin 2000, para riorganizimit të strukturës së sistemit arsimor të Shqipërisë, 80% e nxënësve që morën pjesë në PVNN ishin të rregjistruar në shkollat e mesme. Në atë kohë, përqindja bruto e regjistrimit në atë nivel arsimor ishte vetëm 40 përqind,⁶ që nënkupton se shumë 15 vjeçarë nuk ishin në shkolla dhe kështu ishin të përjashtuar nga kampionët e PVNN-së. Për shkak të ndikimeve në përzgjedhje,⁷ ka gjasa që nëse fëmijët jashtë shkollave do të kishin qenë pjesë e grupit që u përdor si kampion për PVNN-në, performanca mesatare do të kishte qenë shumë më e ulët. Në vitet 2009 dhe 2012 pjesa e nxënësve në shkollën nëntëvjeçare dhe të mesme ishte e shpërndarë në mënyrë më uniforme (50% në të mesme dhe 42 në nëntëvjeçare në vitin 2012) dhe përqindja bruto e regjistrimeve kishte pasur një rritje të dukshme, në 72 përqind në vitin 2009 dhe në 83 përqind në vitin 2012. Kur kjo kombinohet me faktin se niveli bruto i regjistrimeve në shkollat nëntëvjeçare historikisht ka qenë mbi 90 përqind, kjo do të thotë se shumë më tepër 15-vjeçarë u bënë pjesë e kampionëve të PVNN-së në vitet 2009 dhe 2012. Në këtë skenar të zgjerimit të aksesit është domethënëse që Shqipëria arriti të përmirësonte rezultatet.

Rezultatet e përmirësuarra PVNN të Shqipërisë përkojnë me ndërmarrjen e përpjekjeve intensive për reformim në sektorin e saj të arsimit. Qeveria e Shqipërisë nisi procesin e hartimit të strategjisë për sektorin e arsimit në vitin 2002 që rezultoi në miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin (SKA) në vitin 2004 dhe në përpjekjen e parë për të zhvilluar një plan afatgjatë për sektorin. SKA shërbeu si katalizator për një sërë reformash duke përfshirë këtu përmirësimin e rekrutimit të mësuesve, pagave, menaxhimit; rishikimin e kurrikulave për shkollat fillore dhe të mesme të përgjithshme; transparencë dhe llogaridhënie më e madhe përmes reformës së Maturës, vlerësimit kombëtar të nxënësve; çmime më të ulëta dhe cilësi më të mirë të teksteve shkollore përmes një procesi prokurimi të reformuar; dhe sigurimin e subvencioneve për tekstet shkollore për familjet më të varfra. Ndërsa është përtej objektit të këtij raporti përcaktimi i marrëdhënies shkak-pasojë ndërmjet gamës së reformave të politikave dhe rezultateve të përmirësuarra të procesit PVNN, ky raport tregon se efekti i variablave arsimore nuk mund të ndahet nga efekti i variablave socio-ekonomike. Gjithashtu, duke qene se rritja ekonomike ka qenë mesatarisht 4.9 përqind gjatë 2000-2012, një shpjegim i mundshëm është se përmirësimi në kushtet ekonomike ka ndihmuar që të rritet niveli i gjithë treguesve socialë duke përfshirë këtu edhe performancën e PVNN-së.

Pjesa e nxënësve me rezultate nën nivelin bazë është ulur në mënyrë të moderuar që prej vitit 2000. PVNN i kategorizon rezultatet në gjashtë nivele njohurish; nxënësit që marrin pikë nën nivelin 2 në testet e leximit dhe të matematikës konsiderohen përkatësisht analfabetë funksionalë dhe pa njohuritë bazë matematikore.⁸ Sipas të dhënave të vitit 2012, 60 përqind e nxënësve 15 vjeçarë


⁶ Të dhënat për regjistrimet janë marrë nga Instituti i Statistikave i UNESCO-s dhe janë hartuar nga Edstats.

⁷ Është e pritshme që fëmijët jashtë shkollës të jenë pjesë e segmenteve të shoqërisë që janë në kushte të këqija, të cilat janë të prirura të kenë performancën më të keqe.

⁸ PVNN përcakton njohuritë funksionale për shkrim e lexim në lexim si aftësinë e nxënësve për të përdorur informacion të shkruar në situata reale jetësore, duke përfshirë "të kuptojnë, përdorin, reflektojnë dhe ingranohen me tekstet e shkruara për të arritur objektivat individuale, për të zhvilluar njohuritë dhe potencialin dhe për të qenë pjesë e shoqërisë". Për njohuritë bazë matematikore, ajo është shkalla në të cilën nxënësit mund të riprodhojnë njohuri matematikore por edhe se

arrijnë rezultate nën nivelin 2 në matematikë (Figura 2a) që do të thotë se ata nuk janë në gjendje të kuptojnë dhe të zgjidhin probleme matematikore duke kufizuar shumë procesin e zhvillimit dhe të fitimit të aftësive. Tendenca afatgjatë është burim shqetësimi pasi nxënësit që dalin nën nivelin 2 kanë kaluar nga 64% në vitin 2000 në 68% në vitin 2009, para se të binin në vitin 2012. Në bazë të rezultateve PVNN të leximit, përrreth 52 përqind e nxënësve shqiptarë konsiderohen analfabetë funksionalë por ka pasur një përmirësim domethënës nga viti 2000 kur 70 përqind e nxënësve ishin nën nivelin 2 në lexim. Figura 2c paraqet evolucionin e rezultateve të matematikës ndërmjet viteve 2000 dhe 2012 dhe ilustron se më shumë nxënës po shkojnë drejt kufirit të njohurive bazë funksionale të shkrimit e këndimit. Por, në disa nga vendet krahasuese, veçanërisht në Rumani dhe në Bullgari, pjesa e nxënësve nën nivelin 2 pati një rënie dramatike prej 1—16% ndërmjet vitit 2006 dhe 2012 si në matematikë, ashtu edhe në lexim (Figura 2b).

Figura 2. Shpërndarja e nxënësve sipas nivelit të aftësive në matematikë: (a) Progresi i Shqipërisë nga 2000 në 2012; (b) Shqipëria dhe vendet krahasuese në 2012; (c) Evolucionin e rezultateve të matematikës në Shqipëri nga viti 2000 në vitin 2012




Burimi: PVNN 2000, 2009, dhe 2012.

Pavarësisht përmirësimeve, performanca e Shqipërisë është në vendin e fundit mes vendeve krahasuese të rajonit (Figura 3). Rezultatet e Shqipërisë janë më të ulëta nga vendet e Europës dhe

sa mirë mund të nxjerrin me ekstrapolim ato që dinë dhe të aplikojnë njohuritë e tyre matematikore në situata të reja dhe me të cilat ata nuk janë familjarizuar. Në të dyja lëndët, ata që janë nën nivelin 2 mund t'u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me kontekste të njohura ku gjithë informacioni përkatës është i disponueshëm dhe pyetjet janë formuluar shumë qartë. Nxënës të tillë mund të zgjidhin vetëm probleme që janë gjithnjë të dukshme dhe mund të gjenden me ekstrapolim menjëherë nga informacioni i dhënë.

Azisë Qendrore në matematikë dhe në shkencë dhe të parafundit në lexim. Një rezultat i përbërë për të treja lëndët tregon se Shqipëria është 15-30 pikë PVNN pas Malit të Zi, rreth 40 pikë PVNN pas Bullgarisë dhe mbi 100 pikë PVNN pas OBZHE, ku secila diferencë prej 40 pikës është e barabartë me afërsisht një vit shkollim. Ndërkohë që disa vende krahasuese nuk kanë pasur ndonjë përmirësim të madh të rezultateve të tyre ndërmjet vitit 2000 dhe vitit 2012 dhe Shqipëria është vendi më i varfër në këtë grup, boshllëku që Shqipëria duhet të plotësojë mbetet i madh.

Figura 3. Rezultatet PVNN 2012 të Shqipërisë dhe të vendeve krahasuese kundrejt mesatareve të EAQ dhe OBZHE



Burimi: PVNN 2012.

2. Cilësia e dobët dhe pabarazitë e vazhdueshme

Faktorët përcaktues dhe shtytës të cilësisë së arsimit analizohen në tre dimensione: (i) karakteristika individuale; (ii) politika të nivelit të sistemit dhe (iii) politika të nivelit të shkollës. Rezultatet PVNN fillimisht përdoren si një matës i cilësisë së arsimit dhe më pas analizohen efektet e variablave tek nxënësi i PVNN dhe pyetësorët e shkollës mbi rezultatet mësimore. Ne përdorim teknika të ndryshme analitike dhe i ndajmë në vija të gjera variablat në karakteristika individuale dhe të shkollës, me nëngrupe variablash brenda karakteristikave të shkollës (karakteristika të bashkëmoshatarëve, burime dhe praktika shkollore dhe variabla të sistemit). Për shkak se të dhënat e PVNN 2012 nuk janë të besueshme, analiza kufizohet kryesisht tek rezultatet e PVNN 2009 dhe 2000 (Shihni Kutinë 2).

Kutia 2. Indeksi i PVNN për statusin ekonomik, social dhe kulturor dhe vlefshmëria e të dhënave PVNN në Shqipëri

I krijuar nga OBZHE Indeksi PVNN i Statusit Ekonomik, Social dhe Kulturor (SESK) është një matës shumëdimensional që merr në konsideratë informacionin e raportuar nga nxënësit për pasuritë e familjeve të tyre dhe në lidhje me aspektin e punës, arsimit dhe kulturës. Ai del nga kombinimi i tre indekseve të tjera: (i) një indeks për statusin më të lartë të punës të prindërve duke treguar jo vetëm statusin e tregut të punës por edhe llojin e punës që bëjnë prindërit; (ii) një indeks të bazuar në nivelin më të lartë të arsimit që kanë arritur prindërit në vitet e shkollimit; dhe (iii) një indeks të pronave të familjes që në vetvete konsiston në një kombinim të pasurive të familjes (si makina, banja, ose pajisje teknologjike) dhe burimeve edukative si (tavolina, kompjuterë, tekste shkollorë dhe një sërë librash të tjerë), sikurse edhe llojin e pasurive kulturore (si llojin dhe zhanrin e librave ose të punimeve artistike). Indeksi SESK është faktori më i rëndësishëm përcaktues për arritjet e nxënësve dhe prandaj është thelbësor për analizën e cilësisë së informacionit.

Sipas OBZHE rezultatet e abritrazhit konkluduan se Standardet Teknike të PVNN-së arriheshin plotësisht në të gjitha vendet dhe ekonomitë që morën pjesë në PVNN 2012 me përjashtim të Shqipërisë. P.sh. Shqipëria paraqiti të dhëna për punësimin e prindërve që nuk ishin të plota dhe dukeshin të pasakta pasi kishte mbi-përdorim të një game të ngushtë punësh. Nuk ishte e mundur që këto probleme të zgjidheshin gjatë pastrimit të të dhënave dhe si rezultat as të dhënat për punët e prindërve dhe as indekset që vareshin nga ato të dhëna (sikurse Indeksi SESK) nuk janë përfshirë në të dhënat ndërkombëtare.

Për shkak të vlefshmërisë së ulët të të dhënave për sfondet e nxënësve në PVNN 2012, ky studim është mbështetur kryesisht në anketimin PVNN 2009 për analizën e karakteristikave të familjeve.


Burimi: OBZHE 2014.

Pavarësisht përparimit, performanca e ulët e nxënësve në përgjithësi ka gjasa që do të ketë ndikim negativ në zhvillimin ekonomik afatgjatë dhe tek mundësitë për mirëqenie ndër breza. Cilësia e arsimit përmes grupeve është një shqetësim kritik për Shqipërinë. Sikurse u theksua më sipër, shumica e nxënësve kanë pasur rezultate nën nivelin bazë që nga viti 2000. Gjithashtu, një nxënëse shumë e mirë në lexim në Shqipëri- një nga ato që është e një niveli më të lartë se 80 përqind e të gjithë nxënësve shqiptarë – i ka rezultatet më të ulëta se 55 përqind e nxënësve të OBZHE, duke e bërë atë një nxënëse me rezultate mediokre në krahasimet ndërkombëtare. (Figura 4).⁹ Pamja është e njëjtë për matematikën që tregon se nxënësit më të mirë në Shqipëri mbeten nën nivelin e shumicës së nxënësve në OBZHE.¹⁰ Përfitimi i dobët i aftësive që është demonstruar përmes rezultateve të PVNN-së përfaqëson një krizë në fillimet e saj për perspektivat ekonomike dhe sociale të Shqipërisë. Seksioni tjetër ndalet tek pabarazitë e rezultateve mësimore në sistemin arsimor, për identifikimin e grupeve që janë më shumë në rrezik.

⁹ Një nxënëse shqiptarë që arrin nivelin 80% në lexim merr 485 pikë, i cili është i njëjti rezultat si ai i një nxënësi në nivelin 45% në shpërndarjen e nxënësve të OBZHE.

¹⁰ Kjo strukturë është e ngjashme kur shohim të dhënat nga PVNN 2009. Një nxënësi i nivelit 80% në lexim në Shqipëri është nxënësi i nivelit 40% në OBZHE. Në matematikë ky nxënësi do të ishte në nivelin 34%.

Figura 4. Shpërndarja e rezultateve të leximit PVNN 2012 në Shqipëri dhe në OBZHE




Burimi: PVNN 2012.

Pabarazitë në Shqipëri: Cilët nxënës mbesin mbrapa?

Në përgjithësi mundësitë e barabarta në Shqipëri janë të krahasueshme me ato të vendeve të tjera në rajon. Indeksi i barazisë së mundësive (Figura 5) tregon rëndësinë e karakteristikave individuale (gjinia, mosha dhe statusi socio-ekonomik) për të përcaktuar performancën e nxënësve. Në Shqipëri duke përdorur të dhënat e PVNN 2009, karakteristikat individuale shpjeguan përrreth 22 përqind të diferencës në lexim gjë që e vendos vendin rreth mesatarës së EAQ-së.¹¹

¹¹ Ferreira dhe Gignoux (2011) propozojnë një mundësi arsimore duke ndarë variancën e rezultateve të testit që shpjegohet nga rrethana individuale të paracaktuara. Nëse një pjesë e madhe e rezultatit shpjegohet nga këto karakteristika, atëherë niveli i barazisë së mundësive është i ulët.

Figura 5. Indeksi i mundësive të barabarta: Shqipëria dhe vendet e tjera të EAQ-së, 2009



Burimi: Përlogaritjet e autorëve bazuar tek PVNN 2009.

Shënim: Indeksi është përqindja e variancës në rezultatet e leximit e shpjeguar nga karakteristikat kryesore të paracaktuara (mosha, gjinia dhe statusi socio-ekonomik) në një regres linear (Ferreira dhe Gignoux 2011).

Tendencat e performancës tregojnë një diferencë në rritje ndërmjet nxënësit mesatar dhe nxënësve me prejardhje të varfër/disavantazhuar ndërmjet viteve 2000 dhe 2009. Edhe pse Shqipëria ka një pabarazi relativisht të ulët të të ardhurave, ka një dallim të madh ndërmjet performancës së nxënësve në kuantilat më të larta dhe më të ulëta të Indeksit ESKS (Shihni Tabelën 2): 93 pikë në lexim dhe 78 pikë në matematikë, të barazvlerëshme me dy vite shkollim në të dy rastet. Diferenca reflekton edhe dallimet në aksesin në burime shkollore të cilësisë së lartë, në frekuentimin e arsimit parashkollor dhe në praktika më të mira të mësimdhënies në klasë.¹² Ndërsa është e lartë si vlerë absolute, kjo diferencë është e ngjashme me atë të vendeve si Serbia, Kroacia dhe Mali i Zi. Gjithsesi, pa përmirësime të qëndrueshme për të gjithë, nxënësit e varfër/disavantazhuar nuk kanë gjasa që të përmirësojnë standardet e tyre të ardhshme të jetesës. Ndërsa rezultati mesatar i rritjes është i rëndësishëm, ai është gjithashtu thelbësor për të mbështetur përmirësimet mes 40 përqindëshit të poshtëm të nxënësve të një vendi.¹³ Ndërmjet viteve 2000 dhe 2009, nxënësit në 40 përqindëshin e poshtëm përsa i përket statusit socio-ekonomik bënë përparime në lexim në të njëjtin nivel me mesataren e vendit (Figura 6). Në matematikë, performanca e 40 përqindëshit të poshtëm të nxënësve ra më shumë sesa mesatarja. Këto rezultate paraqesin një pamje të zymtë: në vend që të arrijnë mesataren e vendit, nxënësit me prejardhje të varfër/disavantazhuar po mbeten akoma edhe më mbrapa. Kjo ka pasoja të rënda për zhvillimin e vendit dhe për kohezionin social pasi arsimit është një mekanizëm kyç për lëvizshmërinë ndër breza.

¹² Shihni Tabela A.1 në Shtojcë.


¹³ Misioni i Bankës Botërore është artikuluar së fundmi në dy qëllime kryesore: përmirësimi i gjendjes së atyre që janë në varfëri ekstreme dhe nxitja e mirëqenies së përbashkët. Kjo e fundit në këtë raport interpretohet se përfshin 40 përqindëshin e poshtëm për të përfaqësuar edhe njerëz që konsiderohen të varfër në mënyrë të moderuar në vende me të ardhura mesatare si Shqipëria.

Tabela 2. Diferenca në performancë në PVNN 2009 ndërmjet grupeve të kuantileve të sipërme dhe të poshtme socio-ekonomike në Shqipëri

	Lexim			Matematikë		
	Kreu	Fundi	Diferenca	Kreu	Fundi	Diferenca
	20%	20%		20%	20%	
Shqipëria	439	346	93	421	343	78
Bullgaria	502	360	142	496	369	128
Greqia	534	436	98	517	423	94
Kroacia	517	434	83	502	420	82
Mali i Zi	451	364	87	443	360	83
Rumania	472	375	97	468	384	84
Serbia	486	408	78	493	402	91

Burimi: Llogaritjet e autorëve bazuar tek PVNN 2009.

Figura 6. Performanca e nxënësve në matematikë dhe në lexim në PVNN 2000 dhe 2009 sipas grupeve socio-ekonomike




Burimi: PVNN 2000 dhe 2009.

Pabarazitë gjinore

Vajzat shqiptare marin 60 pikë më shumë se djemtë në lexim, shifër kjo e barazvlerëshme me 1.5 vite shkollim. Në shumicën e vendeve vajzat dalin më mirë se djemtë në lexim dhe kanë tendencë që të dalin në nivele të barabarta në matematikë. Në vitin 2009 diferenca gjinore në lexim në Shqipëri ishte më e larta ndërmjet vendeve krahasuese në rajon (Figura 7). Diferenca e madhe në performancë ndërmjet vajzave dhe djemve në lexim ka mbetur mjaft e qëndrueshme ndërsa diferenca në matematikë ka rënë, nga 20 pikë në vitin 2000 në 10 pikë në vitin 2009. Diferenca e madhe gjinore në lexim përbën një sfidë të madhe për Shqipërinë; sistemi i saj arsimor nuk po arrin që të sigurojë barazi për të gjithë nxënësit, sidomos për djemtë. Rezultatet mesatare të nxënësve të OBZHE-së janë afërsisht 140 pikë më të larta sesa rezultatet mesatare të djemve shqiptarë, diferencë kjo e barabartë me afërsisht 3.5 vjet shkollim.

Figura 7. Diferenca gjinore në lexim, PVNN 2009, vende të përzgjedhura



Burimi: PVNN 2009.

Diferenca gjinore del tek aksesin e nxënësve në sistemin parashkollor dhe tek moshën e fillimit të frekuentimit të këtij sistemi. Vetëm 48 përqind e djemve shqiptarë kanë frekuentuar më shumë se një vit sistemin parashkollor ndërsa për vajzat kjo shifër është 58 përqind. Në vendet e OBZHE pjesa e fëmijëve që kanë frekuentuar më shumë sesa një vit institucione të sistemit parashkollor është 70 përqind dhe diferenca gjinore është 2.5 pikë. Gjithashtu, ndërsa 78 përqind e nxënësve të OBZHE e nisin arsimin formal në moshën 6 vjeçare ose më të vegjël, për vitin 2009 këtë e kanë bërë vetëm 49 përqind e fëmijëve shqiptarë. Diferenca gjinore në Shqipëri është gjithashtu e madhe edhe në këtë dimension: vetëm 44 përqind e djemve e nisin arsimin në moshën gjashtë vjeçare ose më të vegjël përkundëjt 54 përqind të vajzave. Në vendet e OBZHE nuk ekziston një diferencë e tillë. Ajo çka është më e rëndësishme, të dhënat e PVNN-së tregojnë se një fillim i hershëm ka lidhje të fortë me rezultate më të larta leximi në Shqipëri, edhe pas kontrollit për disa faktorë duke përfshirë këtu statusin socio-ekonomik, moshën, klasën, gjininë, praktikën e mësuesit, strategjitë e të mësuarit dhe cilësinë e burimeve arsimore. Fillimi i arsimit fillor një vit më parë lidhet me rritjen me përafërsisht 9 pikë të rezultateve të leximit të PVNN-së.¹⁴

Pabarazitë urbane-rurale

Diferenca urbane-rurale është mjaft më e lartë sesa ajo e vendeve të tjera. Në vitin 2009 diferenca urbane-rurale ishte 54 pikë PVNN, pothuajse 1.5 vjet shkollim. Në matematikë dhe në shkencë diferencat ishin më të vogla por jo më pak shqetësuese: 43 dhe 39 pikë, respektivisht, e barabartë kjo me përafërsisht një vit shkollim. Diferencat mesatare urbane-rurale midis vendeve të EAQ-së është 38 pikë në lexim dhe 32 pikë në matematikë, që janë diferenca të mëdha por mjaft më të ulëta se diferencat në Shqipëri. Në mënyrë të ngjashme me diferencën e statusit socio-ekonomik, diferenca urbane-rurale reflekton ndryshimet në akses ndaj shkollave me cilësi më të mirë.¹⁵ Diferenca urbane-rurale përfaqëson një sfidë kritike për Shqipërinë pasi më shumë se 45 përqind e kampionit të saj jetojnë në zonat rurale, shumë e lartë kjo se 30 përqind në të gjitha shtetet pjesëmarrëse dhe 37 përqind në shtetet e EAQ. Kështu, Shqipëria ka një pjesë më të madhe të

¹⁴ Shihni Shtojcën për modelin e plotë.

¹⁵ Shihni Tabela A.2 në Shtojcë.

popullsisë që arrin rezultate shumë të dobëta. Ndryshimi nga viti 2009 në vitin 2012 nuk mund të analizohet për shkak të të dhënave të pasakta në raundin e fundit të PVNN-së.

Shkollat publike dhe private

Diferenca ndërmjet nxënësve në shkollat private dhe ato publike në një masë të madhe shpjegohet nga diferencat në karakteristikat e familjeve dhe burimeve shkollore. Në kampionin e PVNN 2009, 11 përqind e nxënësve në Shqipëri frekuentonin shkolla private. Diferenca në rezultatet e leximit ndërmjet nxënësve në shkolla private dhe atyre në shkolla publike ishte e barabartë me 64 pikë PVNN (e barabartë me një vit e gjysmë shkollim) dhe shpjegohet plotësisht nga karakteristika socio-ekonomike, disponueshmërinë e burimeve arsimore në shkollë dhe nga përqindja e mësuesve të kualifikuar. (Tabela 3).¹⁶

Tabela 3. Karakteristikat e nxënësve sipas llojit të shkollave në vitin 2009

	Shkollat publike	Shkollat private
Rezultati mesatar i leximit (rezultati i PVNN 2009)	378	442
Babai në punë me kohë të plotë (%)	56.0	72.2
Nëna në punë me kohë të plotë (%)	27.7	46.4
Arsimi më i lartë i prindërve (vite)	12.1	13.5
Mësues me arsim të lartë (%)	77.5	95.2
Indeksi i Cilësisë së Burimeve Arsimore	-0.92	0.69

Burimi: PVNN 2009.

Shënim: Indeksi i praktikave të mësimdhënies dhe i strategjive të të mësuarit janë normalizuar në nivelin e OBZHE. Indeksi socio-ekonomik ka një mesatare të kampionit të plotë prej -0.55 dhe një devijim standard prej 1.21. Indeksi i cilësisë së burimeve arsimore ka një mesatare të kampionit të plotë prej -0.28 dhe një devijim standard prej 1.21.

Diaspora shqiptare

Në Greqi dhe në Zvicër, diaspora shqiptare arrin rezultate paksa më të mira se nxënësit në Shqipëri, por kjo nuk ndodh në Malin e Zi. Niveli prej 29 përqind i emigracionit të Shqipërisë është ndër më të lartit në Europë.¹⁷ Edhe personat me arsim të lartë ndjekin të njëjtën tendencë me një nivel emigracioni prej 27 përqind.¹⁸ Tendencja ishte veçanërisht akute në vitet 2000, kur niveli i përgjithshëm i emigracionit u ngrit më shumë se 9 pikë përqindje. Të dhënat e PVNN bëjnë të mundur që të identifikohen fëmijët që jetojnë në një vend tjetër por të cilët ose kanë lindur në Shqipëri ose kanë të paktën një prind që ka lindur në Shqipëri. Figura 8 tregon rezultatet e diasporës shqiptare në Zvicër, Greqi dhe Mal të Zi, vendet me numrin më të lartë të emigrantëve shqiptarë të kohëve të fundit. Në të gjitha këto tre vende, shqiptarët dalin në nivel më të ulët sesa mesatarja e vendit pritës. Gjithësesi, në Zvicër dhe në Greqi, pavarësisht se dalin mjaft nën mesataren e vendit pritës, emigrantët prapë dalin më mirë sesa mesatarja e Shqipërisë, ndërsa shqiptarët e Malit të Zi


¹⁶ Pas kontrollimit të variablave të mëparëshme, lloji i shkollës (publike ose private) nuk i prek shumë rezultatet mësimore.

¹⁷ Një nivel emigrimi prej 29 përqind d.m.th. që për çdo 100 persona të lindur në Shqipëri, 29 prej tyre jetojnë në vendet e OBZHE.

¹⁸ Shihni OBZHE/Kombet e Bashkuara (2013).

dalim më keq se mesatarja shqiptare. Statusi socio-ekonomik i emigrantëve shqiptarë ka tendencën të jetë pak më i lartë në Zvicër sesa ai i nxënësve në Shqipëri.

Figura 8. Performanca e PVNN 2009 në diasporën shqiptare



Burimi: PVNN 2009.

Rëndësia e të mësuarit nga bashkëmoshatarët


Efekti i bashkëmoshatarëve është relativisht i madh në Shqipëri, gjë që është një element i rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë në kontekstin e popullsisë së nxënësve që është në reduktim. Analizat e mëparshme shqyrtonin rëndësinë e karakteristikave individuale që shpjegojnë 22 përqind të diferencave në rezultatet e leximit, afërsisht sa mesatarja prej 23 përqind e EAQ-së. Karakteristikat individuale të llogaritura si mesatare në nivel shkolle (d.m.th. karakteristikat e bashkëmoshatarëve) shpjegojnë edhe një pjesë të diferencave në rezultatet e leximit.¹⁹ Së bashku me karakteristikat individuale, efektet e bashkëmoshatarëve shpjegojnë 29 përqind të variacionit në rezultatet e leximit në vitin 2009. Edhe pse nuk është i lartë krahasuar me vende të tjera në rajon, kjo sugjeron se performanca e nxënësve ndikohet nga bashkëmoshatarët e tyre. Të dhënat e nxjerra nga një ushtrim i kohëve të fundit realizuar në lidhje me vendndodhjet e shkollave sugjerojnë se në Shqipëri ka një rrjet me shkolla të vogla. Ky efekt i bashkëmoshatarëve tek të të mësuarit e nxënësve duhet të merret në konsideratë ndërkohë që qeveria eksploron opsionet për ricaktimin e zonave të shkollave në kontekstin e reduktimit të popullsisë së nxënësve.

Shtresëzimi shoqëror në shkollat shqiptare është i lartë krahasuar me vende të tjera (Figura 9). Ne e përcaktojmë Indeksin e Shtresëzimit të Social të Shkollave si lidhja ndërmjet statusit individual

¹⁹ Karakteristikat individuale dhe efektet e bashkëmoshatarëve zakonisht kanë lidhje të fortë dhe nuk është gjithmonë e lehtë që të ndahen.

socio-ekonomik të PVNN-së dhe statusit socio-ekonomik mesatar në nivel shkollë.²⁰ Në një botë pa shtresëzim social (pra me një indeks të barabartë me pothuajse zero) familjet me prejardhje të ndryshme socio-ekonomike në mënyrë rastësore do të jetonin anembanë vendit dhe nxënës me prejardhje të ndryshme do të studionin së bashku duke bërë kështu që në shkolla të kishte më shumë shumëllojshmëri. Por, familjet kanë tendencën që të bashkë-qëndrojnë në lagje ku ka familje të tjera të ngjashme me to dhe nxënësit kanë tendencën që të frekuentojnë shkollën me bashkëmoshatarë që kanë status të ngjashëm socio-ekonomik si rezultat i pabarazive hapësinore. Duhet të theksohet se vendet me rezultatet më të mira në PVNN kanë tendencën që të kenë sisteme arsimore më pak të shtresëzuar.

Figura 9. Indeksi i shtresëzimit të shkollave në vendet pjesëmarrëse në PVNN, 2009



Burimi: Përlllogaritjet e autorit bazuar tek PVNN 2009.

Shënim: Indeksi shkon nga 0 në 1. Një indeks më i lartë tregon një lidhje më të madhe ndërmjet nxënësve dhe statusit shkollor socio-ekonomik. Figura përfshin një numër të përzgjedhur vendesh pjesëmarrëse në PVNN.

Edhe pse pabarazitë e mëdha socio-ekonomike nuk mund të zgjidhen në planin afatshkurtër, politikat mund të trajtojnë shtresëzimin shkollor. Sikurse u pa më sipër, ndërveprimi me bashkëmoshatarët që zhvillohet në shkollë luan një rol shumë të rëndësishëm për të përcaktuar arritjet e fëmijëve. Në Shqipëri, pavarësisht pabarazisë relativisht të ulët të të ardhurave në nivel kombëtar, nxënësit me prejardhje të ngjashme kanë prirjen të grumbullohen në të njëjtat shkolla. Kjo gjë mund të jetë rezultat i një zgjedhjeje të qartë të prindërve që preferojnë që fëmijët e tyre të rrethohen nga fëmijë me prejardhje të ngjashme socio-ekonomike, por mund ndodhë edhe si pasojë e faktorëve të tjerë si p.sh vendi se ku jeton secili grup ose një provim që orienton nxënësit në profile të ndryshme. Rrjeti i shkollave në Shqipëri është i tillë që 69 përqind e shkollave kanë dy ose më shumë shkolla në të njëjtën zonë. Kjo u jep mundësi politikëbërësve që të promovojnë integrimin social dhe si pasojë të përmirësojnë arsimin në pjesën më të madhe të vendit. Provat

²⁰ Shihni Banka Botërore (2013).

ndërkombëtare tregojnë se sistemet që shtresëzojnë nxënësit sipas statusit socio-ekonomik rrisin pabarazinë në performancën e studentëve pa përmirësuar nivelet mesatare të performancës.²¹

Politikat e fëmijërisë së hershme

“Efekti i arsimit parashkollor” tek të mësuarit që vihet re në vendet e OBZHE nuk është i pranishëm në Shqipëri. Diferenca në performancën në lexim ndërmjet nxënësve që nuk kishin frekuentuar institucion parashkollor dhe atyre që kishin frekuentuar institucion parashkollor për më shumë se një vit është 32 pikë (dhe 14 pikë duke krahasur mos frekuentim të institucionit parashkollor me frekuentimin për një vit), shumë më pak se diferenca në vendet e OBZHE-së (66 pikë) por larg krahasuesve rajonalë si Krocia (28 pikë) dhe Sllovenia (40 pikë). Pas kontrollimit të faktorëve të tjerë (si p.sh statusi socio-ekonomik, mosha, klasa dhe gjinia), ndikimi pozitiv nga frekuentimi për më shumë se një vit i institucioneve parashkollore bie në 5 pikë, që nënkupton se pjesë e efektit të frekuentimit të institucioneve parashkollore është e përzierë me efekte të karakteristikave të tjera. Edhe pse të dhënat nuk lejojnë që të kemi një përgjigje plotësisht të qartë se përse efekti parashkollor nuk është aq i madh në Shqipëri, një nga shpjegimet ka lidhje me cilësinë e programeve që ofrohen. Në mënyrë që t’i japim përgjigje kësaj pyetjeje nevojitet një analizë që del jashtë objektit të këtij studimi, por provat globale tregojnë se sigurimi i arsimit parashkollor cilësor ka rëndësi për të mbështetur zhvillimin social, emocional, fizik dhe njohës; gjithashtu ai rrit përgatitjen për në shkollë që ndihmon për të mësuarin (Heckman and LaFontaine 2010; Heckman 2008; Engle *et al.* 2011). Diferencat në aftësitë njohëse fillojnë herët dhe pabarazitë në aksesin në institucionet parashkollore bëjnë që këto të vazhdojnë të ekzistojnë pa fund. Përveç problemeve të cilësisë, Shqipëria ballafaqohet me një sfidë për aksesin dhe barazinë. Të dhënat e Anketimit për Matjen e Standardeve të Jetesës (AMSJ) 2012 bëjnë të mundur që të bëhet zberthimi sipas kuantileve të konsumit dhe tregojnë se niveli i regjistrimit varion ndërmjet 20 përqind (për më të varfërit) dhe 48 përqind (për më të pasurit).²²

Si ndikojnë praktikrat në nivel klase tek të mësuarit?

PVNN ofron mundësinë për të eksploruar plotësisht një lëndë çdo tre vjet, edhe pse të treja lëndët vlerësohen çdo herë që ai administrohet. PVNN synon të vlerësojë jo thjesht nëse nxënësit mund të riprodhojnë njohuri, por edhe të shqyrtojë se sa mirë mund të nxjerrin ata atë që kanë mësuar dhe ta aplikojnë në një situatë me të cilën nuk janë të familjarizuar si në shkollë, ashtu edhe jashtë saj. Testi i hollësishëm i aftësive për elementët në një lëndë të caktuar është një vlerësim i hollësishëm me një grup më të madh pyetjesh. Vlerësimi i hollësishëm në vitet 2000 e 2009 ishte për leximin, në vitet 2003 dhe 2012 për matematikën dhe në vitin 2006 për shkencën. Rauti i vitit 2015 do të përqendrohet sërish tek shkenca. Pra, për Shqipërinë disponohen dy vlerësime të hollësishme për leximin dhe një vlerësim i hollësishëm për matematikën.

²¹ Shihni Hanushek dhe Woessmann (2006).

²² Shihni Banka Botërore (e ardhshme). Statistika zyrtare dhe analiza e AMSJ ofrojnë shifra regjistrimi që nuk përputhen. Sipas të parës kjo shifër është 73 përqind ndërsa sipas të dytës është 33 përqind.

Aftësitë matematikore në PVNN 2012

Vlerësimi i elementëve **për matematikën PVNN 2012 mati aftësitë e individëve për të formuluar, përdorur dhe interpretuar matematikën në një sërë kontekstesh dhe fushash të ndryshme.** Në PVNN koncepti i njohurive bazë matematikore përfshin: (i) arsyetimin matematikor; (ii) përdorimin e koncepteve, procedurave dhe fakteve matematikore; (iii) mjetet për të përshkruar, shpjeguar dhe parashikuar fenomene; dhe (iv) rolin që luan matematika në botë dhe nevojën për të bërë gjykime dhe për të marrë vendime të bazuara mirë që nevojiten nga qytetarët konstruktivë, të angazhuar dhe që reflektojnë. Gjithashtu, njohuritë bazë matematikore sikurse përkufizohet nga PVNN, nuk janë një atribut që një individ e ka ose nuk e ka; përkundrazi ato mund të përfitohen në një shkallë më të madhe ose më të vogël dhe duhen në shoqëri në shkallë të ndryshme. PVNN kërkon të masë jo vetëm shkallën në të cilën nxënësit mund të riprodhojnë njohuri matematikore por edhe se sa mund të nxjerrin ata atë që kanë mësuar dhe të zbatojnë njohuritë e tyre në situata të reja. Pyetjet me të cilat ballafaqohen nxënësit janë brenda një kuadri prej katër kategorish nga bota e vërtetë: personale, të shoqërisë, të punës dhe shkencore. Kutia 3 ilustron një pyetje tipike matematikore nga PVNN 2012.

Kutia 3. Shembulli i problemeve matematikore nga PVNN 2012: Cilën makinë?

Problemi i mëposhtëm ishte pjesë e anketimit kryesor të PVNN 2012. Pyetja e parë kërkon interpretim dhe është në kategorinë “pasiguri dhe të dhëna” ndërsa dy pyetjet e tjera masin “sasinë” dhe kërkojnë që nxënësit të përdorin fakte matematikore.

CILËN MAKINË?- Një ushtrim nga PVNN 2012

CILËN MAKINË?

Krisi sapo ka marrë patentën dhe do që të blejë makinën e saj të parë. Më poshtë jepen hollësitë për katër makina që ajo gjeti te dyqani lokal.

Modeli	Alpha	Bolte	Castel	Dezal
Viti	2003	2000	2001	1999
Çmimi me te cilin reklamohen (në zedë)	4800	4450	4250	3990
Sa km ka bërë makina	105 000	115 000	128 000	109 000
Kapaciteti i motorrit (në litra)	1.79	1.796	1.82	1.783

Cilën makinë? – PYETJA 1

Krisi do një makinë që plotëson të gjitha këto kushte:

- Të mos ketë bërë më shumë se 120 000 km
- Të jetë prodhim i vitit 2000 ose i ndonjë viti më të vonë
- Çmimi me të cilin reklamohet të mos jetë më i lartë se 4500 zedë.
- Cila makinë i plotëson kushtet e Kristit?
A. Alpha
B. Bolte
C. Castel
D. Dezal

Cilën makinë? – PYETJA 2

Cila makinë ka motorrin me kapacitet më të vogël?

- A. Alpha
- B. Bolte
- C. Castel
- D. Dezal

Cilën makinë? – PYETJA 3

Kristi duhet të paguajë taksa një shumë ekstra prej 2.5% mbi koston e reklamuar të makinës.

Sa është kjo shumë për makinën Alpha?

Shuma ekstra për taksat në zedë është:

.....


Niveli i vështirësisë së problemit vlerësohet me 327.8 pikë për pyetjen 1, 490.9 pikë për pyetjen 2 dhe 552.6 për pyetjen 3. Në Shqipëri, 80 përqind e nxënësve ishin në gjendje të arrinin nivelin e vështirësisë së pyetjes 1 (në mesataren e matematikës). Por kjo shifër ra në mënyrë dramatike tek vetëm 13 përqind për pyetjen 2 dhe më pak se 3 përqind për pyetjen 3. Përkundrazi, në vendet e OBZHE-së 96 përqind e nxënësve i zgjidhën pyetjet në nivelin e pyetjes 1, 47 përqind për pyetjen 2 dhe 25 përqind për pyetjen 3.

Burimi: OBZHE 2014.

Kuadri matematikor i PVNN-së është një mjet i sofistikuar për të lidhur zotërimin e proceseve matematikore nga nxënësi me përmbajtjen. Vlerësimi i elementëve matematikorë bën vlerësimin e kapacitetin në katër kategori përmbajtjeje (Figura 10): *sasi* (përfshin vlerësimin nga ana sasiore të attributeve të objekteve, marrëdhënieve dhe të entiteteve), *pasiguri dhe të dhëna* (të kuptohen mesazhet që ndodhen tek të dhënat dhe të vlerësohet ndryshueshmëria që ekziston në shumë procese reale), *ndryshimi dhe marrëdhëniet* (marrëdhëniet e përkohëshme dhe të përherëshme midis objekteve dhe rrethanave) dhe *hapësira dhe trajta* (fenomene të hasura në modele, tipare të objekteve, simbole, informacion vizual, navigim dhe ndërveprime dinamike). Figura 10 tregon gjithashtu një skemë të fazave me të cilat ballafaqohet një nxënës kur është duke zgjidhur një problem nga jeta reale përmes ciklit modelues matematikor. Veprimi fillon me identifikimin e

problemit në kontekst dhe përfundon kur rezultatet e problemit gjenden në një kontekst dhe sërisht reflektohen në kontekstin e problemit. Ky proces përfshin katër aftësi që përkufizohen nga PVNN si “proceset”, të vlerësuara në vitin 2012 si: *formuloj* një situatë matematikore sipas koncepteve dhe marrëdhënieve të identifikuara, *përdor* fakte, procedura matematikore dhe arsyetim për të nxjerrë rezultatet (zakonisht kjo përfshin llogaritje, manipulim ose njehsim), *interpretoj* rezultatet në kuadrin e problemit origjinal për të nxjerrë “rezultatet në kontekst” dhe së fundmi, *vlerësoj* rezultatet dhe se sa të arsyeshme janë ato në kontekstin e problemit.²³

Figura 10. Përmbajtja matematikore dhe kategoritë e procesit në PVNN




Burimi OBZHE 2014.

Nxënësit shqiptarë dalin shumë më mirë në ushtrimet që lidhen me hapësirën por kanë vështirësi që të lidhin problemet matematikore me situatat e jetës reale (Figura 11). Krahasuar me performancën mesatare matematikore²⁴ rezultatet e Shqipërisë tregojnë një variacion të lartë përmes vlerësimeve të elementëve krahasuar me vendet e OBZHE-së. Përsa i përket performancës së përgjithshme, nxënësit në Shqipëri dalin mirë në problemat e lidhura me hapësirën dhe trajtën, që zakonisht lidhen me gjeometrinë por dalin nën nivel në elementët që kanë të bëjnë me ndryshimin dhe marrëdhëniet, pasigurinë dhe të dhënat dhe sasinë. Rezultatet në elementët e proceseve tregojnë se nxënësit dalin nën nivel kur duhet të përdorin aftësitë për vendosjen e gjërave në kontekst për të lidhur problemet me jetën e vërtetë dhe me situatat të përditëshme.

²³ Dy proceset e fundit janë përmbledhur në një aftësi të vetme në të dhënat PVNN të nxënësve

²⁴ “Performancë mesatare matematikore” i referohet rezultatit mesatar në të gjitha rezultatet për elementët matematikorë

Figura 11. Performanca në PVNN 2012 elementët e ndryshëm matematikorë krahasuar me performancën mesatare të secilit grup



Burimi: PVNN 2012.

Shënim: Rezultati mesatar i Shqipërisë është 394 dhe ai i OBZHE-s është 494.

Aftësitë e leximit në PVNN 2009


Në vlerësimin e aftësive të elementëve të leximit në PVNN 2009 u mat aftësia e nxënësve për të aplikuar leximin në mënyrë aktive, të qëllimshme dhe funksionale në një sërë situatash. PVNN e përkufizon shkrimin e leximit si *kuptimin, përdorimin, reflektimin ndaj dhe ingranimin me* tekste të shkruara për të arritur qëllimet, për të zhvilluar njohuritë dhe potencialin dhe për të qenë pjesë e shoqërisë. *Kuptimi* i referohet aftësisë së lexuesit për të nxjerrë kuptimin nga teksti; *përdorimi* i referohet llojit të leximit që drejtohet drejt aplikimit të informacionit të një teksti në një detyrë imediate; dhe *reflektimi ndaj* do të thotë që lexuesit e lidhin atë që po lexojnë me mendimet dhe përvojat e tyre.

Kutia 4. Shembull leximi nga PVNN 2009: Fuqia punëtore

Teksti i mëposhtëm ishte pjesë e vlerësimit për leximin të PVNN 2009. Është një shembull teksti jo të vazhdueshëm; aftësia për elementët e matur është kapaciteti për të nxjerrë informacion. Pyetja që u drejtua ishte “Sa njerëz të moshës për të punuar nuk ishin pjesë e fuqisë punëtore? (Shkruani numrin e personave, **jo** përqindjen e tyre.)”

Diagrama e mëposhtme në formë peme tregon strukturën e fuqisë punëtore të një vendi ose “popullsinë në moshë pune”. Popullsia totale e vendit në vitin 1995 ishte përrreth 3.4 milionë.

Struktura e fuqisë punëtore, viti që mbaron në 31 mars 1995 (në mijëshe-



1. Numrat e njerëzve jepen në mijëshe (000)

2. Popullsia në moshë pune përkufizohet si njerëzit ndërmjet moshës 15 dhe 65 vjeç.

3. Njerëzit që “nuk janë pjesë e fuqisë punëtore” janë ata që nuk kërkojnë punë në mënyrë aktive dhe/ose nuk janë të disponueshëm për të punuar.

4. Burimi: D. Miller, Form 6 Economics, ESA Publications, Box 9543, New Marker, Auckland, NZ, p.64.

Pikë të pjesshme iu dhanë nxënësve që u përgjigjën “949.9” dhe pikë të plota iu dhanë atyre që arritën të gjenin se numri real i njerëzve ishte 949,000. Niveli i vështirësisë i përgjigjes me pikë të pjesshme u vlerësua me 485 ndërsa ai për pikët e plota me 631. Vetëm 20 përqind e nxënësve shqiptarë arritën nivelin e vështirësisë së pyetjes që merrte pikë të pjesshme (në mesataren e leximit).

Më pak se 1 përqind e nxënësve shqiptarë arritën nivelin për të marrë pikë të plota. Ndryshe nga kjo, në vendet e OBZHE 65 përqind e nxënësve e zgjidhën pyetjen në nivelin e vështirësisë së përgjigjes për pikë të pjesshme, ndërsa 28 përqind e nxënësve e zgjidhën pyetjen në nivelin e vështirësisë së përgjigjes për pikë


Kuadri i leximit i PVNN-së është ndërtuar mbi tre karakteristika kryesore: *tekste, aspekte dhe situata*.

Edhe pse tekstet diferencohen nga karakteristika të ndryshme (mesatarë, mjedis, lloj, dhe format) performanca tek *formati i tekstit* është e vetmja që raportohet në PVNN përmes dy formateve: *tekste të vazhdueshme* (fjali të organizuara në paragrafë të cilat mund të jenë pjesë e strukturave edhe më të mëdha) dhe *tekste jo të vazhdueshme* (fjali më të shkurtra, zakonisht në lista me shembuj, grafikë, diagrama ose katalogë), edhe pse janë të përziera me tekste të shumta. *Aspektet* maten si elementë të leximit PVNN brenda tre kategorive: *akses dhe marrje* (aftësitë që lidhen me gjetjen, përzgjedhjen dhe grumbullimin e informacionit), *integrim dhe interpretim* (që ka të bëjë me të kuptuarin e marrëdhënieve ndërmjet pjesëve të ndryshme të një teksti ose të nxjerrit të kuptimit nga diçka që nuk shprehet në tekst), dhe *reflektim dhe vlerësim* (që ka të bëjë me përdorimin e njohurive, ideve ose vlerave të jashtme të tekstit). Së fundmi, *situatat* kanë si synim të maksimizojnë shumëllojshmërinë e përmbajtjes të përfshirë në anketimin e leximit të PVNN-së; p.sh. përfaqësohen situata personale, publike, arsimore dhe profesionale.

Nxënësit shqiptarë e kuptojnë tekstin e vazhdueshëm shumë më mirë sesa tekstin jo të vazhdueshëm dhe është e nevojshme që të përmirësohen aftësitë e tyre për të reflektuar dhe për të vlerësuar. Duke krahasur rezultatet e elementëve të leximit me performancën mesatare të leximit²⁵ del që Shqipëria tregon më shumë variacion ndërmjet elementëve sesa vendet e OBZHE-së që do të thotë se ka shumë vend për përmirësim në disa elementë. Në veçanti, nxënësit dalin më mirë në lidhje me tekstet tradicionale sesa në tekste që përmbahen në lista, grafikë ose diagrama (më shumë se 25 pikë diferencë, e barabartë kjo me gjysëm viti shkollim). Gjithashtu, PVNN tregon dobësitë e nxënësve shqiptarë në bërjen e lidhjes mes përvojave të tyre dhe tekstit duke reflektuar kështu një shkoputje ndërmjet asaj që nxënësit mësojnë dhe aftësisë së tyre për ta aplikuar atë në situata të jetës reale.

²⁵ "Performanca mesatare e leximit" i referohet rezultatit mesatar të gjithë rezultateve të elementëve të leximit.

Figura 12. Performanca PVNN 2012 në elementët e ndryshëm të leximit krahasur me performancën mesatare në lexim të secilit grup



Burimi: PVNN 2009.

Shënim: Rezultati mesatar i Shqipërisë është 385 ndërsa ai i OBZHE-së është 493.

Praktikat e mësimdhënies dhe strategjitë e të mësuarit në lexim

Praktikat e mësimdhënies dhe strategjitë e të mësuarit kanë një ndikim të madh tek performanca.²⁶ Për të kuptuar se deri në çfarë mase teknikat e dobëta të mësimdhënies që përdoren në klasë pengojnë zhvillimin e nxënësve, ky studim krijon dy indekse që kanë të bëjnë me: (i) strategjitë e nxënësve në klasë për kontrollin, përpunimin, memorizimin dhe kuptimin; dhe (ii) si mësuesit (sikurse informohet nga nxënësit) i angazhojnë nxënësit, sigurojnë një klimë të përshtatshme disiplinore, si menaxhojnë detyrat dhe si i ndihmojnë nxënësit që të tregojnë për njohuritë e tyre.²⁷ Analiza e rezultateve PVNN në mbarë botën identifikon se nevojiten vlera më të larta të këtyre dy indekseve në mënyrë që të sigurohet se të gjithë mësojnë.²⁸ Gjithashtu, përqindja e mësuesve të kualifikuar (ata me arsim të lartë) në një shkollë ndikon pozitivisht tek rezultatet e leximit: për çdo pikë përqindje shtesë në pjesën e mësuesve të kualifikuar të shkollës, ka një rritje prej 3 pikësh në rezultatin e leximit të PVNN-së. Analiza shpjegonte: (i) strategjitë e të mësuarit të përdorura nga nxënësit; (ii) praktikat e mësimdhënies të përdorura në shkolla; dhe (iii) cilësinë e burimeve arsimore; ndërsa (iv) kontrolloheshin një sërë karakteristikash individuale dhe të bashkëmoshatarëve sikurse është përshkruar më parë.

²⁶ Përgjigjet për praktikat dhe rutinën e mësimdhënies si dhe për strategjitë e të mësuarit të nxënësve raportohen nga nxënësit në Pyetësorin PVNN për Nxënësve.


²⁷ Indeksi ndërtohet nga koeficientët e regresit linear të rezultateve të leximit kundrejt indekseve tek PVNN 2009 të praktikave dhe strategjive veç e veç.

²⁸ Shihni tek Shtojca Tabelën A.3 për një përshkrim të variablave dhe Tabelën A.4 për një përmbledhje të rezultateve të regresit.

Pabarazitë hapësinore shpjegohen në një masë të madhe nga karakteristikat individuale dhe të bashkëmoshatarëve edhe pse politikat efektive të mësuesve mund të ngushtojnë këtë diferencë. Analiza e faktorëve përcaktues të cilësisë së shkollës tregon një rol kritik të praktikave të mësimdhënies dhe të strategjive të të mësuarit si për Shqipërinë, ashtu edhe për vende të tjera pjesëmarrëse në PVNN.

Zbërthimi i diferencave në performancën në lexim ndërmjet nxënësve në qytete të mëdha (me 100, 000-1,000,000 banorë) dhe vendeve më të vogla gjeografike tregon se diferencat nxiten kryesisht nga karakteristika socio-ekonomike individuale dhe të bashkëmoshatarëve. Megjithatë, për vende më pak të populluara si fshatra (më pak se 3, 000 banorë), qytete të vogla (3, 000 -15, 000 banorë) dhe qytete (15, 000-100, 000 banorë) një përmirësim në strategjitë efektive të të mësuarit dhe në praktikatat e mësimdhënies mund të ndihmojë për të ngushtuar diferencën me përreth 10 pikë (Figura 13). Në rezultatet e paraqitura në Figurën 13, “të pashpjeguar” i referohet kombinimit të faktorëve sistemikë të ndryshimit dhe efekteve që mbeten të cilat nuk janë marrë nga të dhënat e PVNN-së, duke përfshirë praktikatat e qeverisjes dhe të menaxhimit, normat sociale e kulturore, efektivitetin e mësuesve dhe drejtorëve.

Figura 13. Zbërthimi i diferencave në performancën e leximit ndërmjet fshatrave/qyteteve dhe qyteteve të mëdha (PVNN 2009)



Burimi: Llogaritjet e autorëve bazuar në të dhënat e PVNN 2009.

Shënim: Zbërthime të dyfishta Oaxaca u realizuan duke krahasur secilën diferencë të vendndodhjeve gjeografike me qytetet e mëdha dhe duke përfshirë indekset e strategjive të të mësuarit dhe të praktikave të mësimdhënies. Faktorët “e pashpjeguar” përfshijnë agregimin e diferencave që shpjegohen nga kthimi tek karakteristikat e ndividit dhe të shkollës dhe tek pjesa e mbetur e zbërthimit të trefishtë Oaxaca.²⁹

²⁹ Shihni Shtojcën, Tabela A.5. Zbërthimi Oaxaca-Blinder i diferencës së performancës në lidhje me qytetet, PVNN 2009

Strategjitë e të mësuarit dhe praktikat e mësimdhënies shpjegojnë një pjesë të rëndësishme të diferencës në lexim ndërmjet vajzave dhe djemve. Seksioni i mëparshëm tregoi se në shumicën e vendeve vajzat dalin më mirë sesa djemtë në lexim dhe diferenca zakonisht është të paktën një vit shkollim. Një zberthim i faktorëve përcaktues të diferencës gjinore në lexim identifikon strategjitë e të mësuarit si një arsye kritike se përse djemtë mbesin prapa krahasuar me vajzat (kryesisht moshë kur fillojnë arsimin dhe praktikat e mësimdhënies janë gjithashtu të rëndësishme). Pjesa më e madhe e diferencës (80 përqind) shpjegohet nga diferencat në kthimin tek karakteristikat individuale dhe të shkollës, të cilat sugjerojnë se djemtë dhe vajzat përdorin modele të ndryshme të të mësuarit për leximin.³⁰

3. Rekomandime

Një sistem efektiv vlerësimi është i prirur të përfshijë tre lloje veprimtarish kryesore vlerësuese, secila prej të cilave i shërben qëllimit dhe trajton nevoja të ndryshme për informacion. Këto tre lloje kryesore janë: një vlerësim në klasë, provime dhe vlerësime të shkallës së madhe në nivel sistemi. Në kategorinë e fundit, vlerësimet ndahen më tej në vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare. PVNN është një vlerësim ndërkombëtar në shkallë të madhe. Në Shqipëri, ai ofron të vetmin burim informacioni mbi rezultatet mësimore të nxënësve që është i krahasueshëm me kalimin e kohës.

PVNN e përkufizon veten si një vlerësim që bazohet tek aftësitë dhe për të cilin nuk përdoret kurrikulum. Me aftësi kuptojmë atë që mund të bëjnë nxënësit me njohuritë e tyre dhe janë përzgjedhur nga një grup detyrash që një person duhet të dijë të bëjë në mënyrë që të jetë i suksesshëm në jetë. Megjithëse rezultatet PVNN mund të përdoren për të informuar reformat në kurrikula, programe vlerësimi dhe zhvillim profesional për mësuesit, ato nuk duhet të jenë burimi i vetëm i informacionit për politikëbërësit. Një sistem i integruar vlerësimi që përfshin gamën e plotë të vlerësimeve të përshkruara më sipër duhet të reflektojë përmbajtjen e kurrikulimit, të jetë objektiv dhe i paanshëm dhe të japë rezultate në një mënyrë që mbështet sistemin që të identifikojë fusha ku nevojiten studime të mëtejshme apo marrja e masave për rregullimin e gjendjes. Ndërsa rezultatet PVNN përfaqësojnë një pikë të mirë nisjeje për të diskutuar reformën arsimore, ka kufizime për konkluzionet që mund të nxirren prej tyre.

Duke pasur paraysh këtë paralajmërim, këto rekomandime për politika dalin nga ky studim:

1. **Të arrihet konsensus në nivel kombëtar për përmirësimin e cilësisë së arsimit në përgjithësi.** Arritjet e nxënësve të matura nga PVNN u përmirësuan nga viti 2000 në vitin 2012, sidomos në lexim. Gjithësesi, performanca mbetet e ulët dhe shumica e nxënësve kanë rezultate që janë nën nivelin bazë si në lexim ashtu edhe në matematikë. Pavarësisht disa përpjekjeve reformuese gjatë dekadës së kaluar, alokimi i burimeve për arsimin mbetet i pamjaftueshëm dhe ka pak shpresa për rritjen e shpenzimeve publike në kontekstin e kufizimeve fiskale në planin makro. Në planin afatshkurtër, qeveria ballafaqohet me sfidën për të vazhduar përmirësimin e cilësisë së arsimit ndërsa kërkon të fitojë nga efikasiteti në sektor. Në planin afatmesëm-afatgjatë është e qartë se duhen reforma tërësore dhe të koordinuara për të përshpejtuar progresin në sektor, duke filluar me

³⁰ Shihni Shtojcën, Tabela A.6.

konsensus në nivel kombëtar për të vendosur si prioritet përmirësimin e objektivave mësimore dhe sigurimin e zhvillimit të aftësive për të gjithë. Në rast se nuk pranohet që reforma arsimore paraqet një mundësi unike për të prodhuar një bërthamë punonjësish me aftësi të përshtatshme dhe fleksibël, zhvillimi katalitik ekonomik dhe social nuk do të mund të arrihen në Shqipëri.

2. **Të drejtohen burimet arsimore dhe mësuesit e kualifikuar në një mënyrë të tillë që të përfitojnë nxënësit që janë në kushte më të këqija.** Disa grupe mbesin mbrapa sistematikisht. Tendenca më shqetësuese është rritja e dallimit ndërmjet nxënësve në kuantilet më të larta dhe më të ulëta të Indeksit SESK të OBZHE-së nga viti 2000 në vitin 2009 duke rezultuar kështu në një diferencë në performancë e cila është ekuivalente me përreth dy vite shkollare si në matematikë, ashtu edhe në lexim. Gjithashtu, diferenca ndërmjet djemve dhe vajzave është më shumë se 60 pikë në lexim, ndërsa diferenca urbane-rurale është më shumë se 50 pikë e cila është ekuivalente me afërsisht një vit e gjysëm shkollor. Edhe pse i gjithë sektori arsimor është i kufizuar nga burimet, më shumë fonde duhet të kenë si fokus djemtë, nxënësit me prejardhje të varfër/disavantazuar, dhe ata që jetojnë në zonat rurale. Shkollave rurale mund t'u nevojiten më shumë burime për shkollat për të zvogëluar diferencën në mjediset socio-ekonomike të nxënësve dhe duhet të ketë stimuj për të siguruar që mësuesit më të mirë të merren me nxënësit më të vështirë. Në lidhje me këtë, ekzistenca e zonave të mbivendosura për shkollat dhe numri në rritje i shkollave të vogla paraqet mundësi për të konsideruar opsionet për rindarjen e zonave të shkollave në një mënyrë të tillë që t'i bëjë shkollat më pak të shtresëzuara dhe të promovojë rezultate më të barabarta.
3. **Të rritet efektiviteti i praktikave të mësuesve pasi kjo është forca kyçe për arritjen e cilësisë.** Analiza thekson rëndësinë e praktikave efektive të mësimdhënies, strategjive të të mësuarit nga nxënësit (pjesërisht produkt e praktikave të mësimdhënies), dhe ndikimin pozitiv kur ka një pjesë të madhe mësuesish të kualifikuar nëpër shkolla. Programet për këshillimin dhe mbështetjen nga kolegët së bashku me vëzhgimet në klasë, zhvillimin profesional të mësuesve të përqendruar tek përmirësimi i efektivitetit në klasë dhe sistemet e reagimit për mësuesit mund të bëjnë dallimin për përforcimin e teknikave të menaxhimit të klasës dhe për të promovuar teknikat përkatëse pedagogjike.
4. **Të zgjerohet mbulimi dhe të monitorohet cilësia e arsimit parashkollor.** Arsimi parashkollor ka potencialin që të zbusë pabarazitë herët në jetë dhe të krijojë kushte të barabarta që në fillim për nxënësit e varfër/disavantazuar. Të dhënat e PVNN-së tregojnë së fillimi i hershëm në shkollën fillore ka një lidhje të fortë me rezultatet e larta të leximit në Shqipëri edhe pas kontrollit të disa faktorëve. Por analiza e variancës për aksesin në arsimin parashkollor ose fillimi i arsimit fillor në moshën gjashtë vjeçare paraqet pabarazi përgjatë kuantilave socio-ekonomike sikurse edhe ndërmjet djemve dhe vajzave. Në kontekstin kur qeveria po konsideron futjen e notës 0 në arsimin e detyruar, do të nevojiten përpjekje të posaçme për të siguruar që djemtë dhe nxënësit me status të ulët socio-ekonomik të jenë objekt i regjistrimeve. Gjithashtu, cilësia e arsimit të hershëm në Shqipëri duhet të përforcohet dhe të monitorohet për të siguruar që në Shqipëri të arrihet "efekti i arsimit parashkollor".
5. **Të përmirësohet forca e të dhënave, besueshmëria dhe aksesit tek to.** Sipas OBZHE-së Shqipëria është i vetmi vend të dhënat për familjet e të cilit për PVNN 2012 nuk janë të besueshme. Ndërsa Shqipëria përgatitet për të marrë pjesë tek PVNN 2015, duke përfshirë edhe përdorimin pilot të

instrumenteve para pranverës së vitit 2015, është kritike që të ketë mekanizma për të siguruar cilësinë e mbledhjes së të dhënave në mënyrë që politikat të mbështeten në prova. Anketimet ndërkombëtare si PVNN mund të jenë të kushtueshme por ato kanë potencialin për të ndihmuar politikëbërësit që të identifikojnë dobësitë në sektorin e arsimit dhe prandaj ato duhet të shfrytëzohen në maksimum

Referenca

- Engle, P., L. Fernald, H. Alderman, J. Behrman, C. O'Gara, A. Yousafzai, M. Cabral de Mello, M. Hidrobo, N. Ulkuer, I. Ertem, S. Iltus, and Global Child Development Steering Group. 2011. "Strategies for reducing inequalities and improving developmental outcomes for young children in low-income and middle-income countries." *The Lancet*- 8 October Vol. 378, Issue 9799: 1339-1353). DOI: 10.1016/S0140-6736(11)60889-1.
- Ferreira, H.G., and J. Gignoux. 2011. "The Measurement of Educational Inequality: Achievement and Opportunity." IZA Discussion Paper No. 6161.
- Hanushek, E. 2010. "The High Cost of Low Educational Performance. The long-run economic impact of improving PISA outcomes." OECD Publications.
- Hanushek, E., and L. Woessmann. 2006. "Does Educational Tracking Affect Performance and Inequality? Differences-in-differences evidence across countries." *The Economic Journal* Vol. 116, Issue 510: C63-C76.
- Hanushek, E., and L. Woessmann. 2007. "The Role of Education Quality in Economic Growth." World Bank Policy Research Working Paper 4122. World Bank, Washington, DC.
- Hanushek, E., and L. Woessmann. 2010. "The Economics of International Differences in Educational Achievement". NBER Working Paper 15949.
- Hanushek, E., and L. Woessmann. 2012. "Do Better Schools lead to more growth? Cognitive skills, economic outcomes, and causation." *Journal of Economic Growth* Vol. 17: 267-321.
- Heckman, J. 2008. "Schools, skills, and synapses." *Economic Inquiry* 46(3): 289-324.
- Heckman, J., and P. LaFontaine. 2010. "The American High School Graduation Rate: Trends and Levels." *Review of Economics and Statistics* 92(2): 244-262.
- OECD. 2012a. "PISA 2009 Technical Report." Paris: OECD. Retrieved April 10, 2014 from <http://www.oecd.org/pisa/pisaproducts/50036771.pdf>
- OECD. 2012b. "PISA 2009 Results: Learning to Learn – Student Engagement, Strategies and Practices (Volume 3)." Paris: OECD.
- OECD. 2014. "PISA 2012 Results: What Students Know and Can Do." Paris: OECD. Retrieved April 10, 2014 from <http://www.oecd.org/pisa/keyfindings/pisa-2012-results-volume-I.pdf>
- OECD/United Nations. 2013. "World Migration in Figures." Retrieved May 18, 2014 from <http://www.oecd.org/els/mig/World-Migration-in-Figures.pdf>.
- Sala-i-Martin, X., G. Doppelhofer, and R.I. Miller. 2004. "Determinants of long-term growth: A Bayesian averaging of classical estimates (BACE) approach." *American Economic Review* 94 (4), 813-835.

World Bank. 2013. "Promoting Excellence in Turkey's Schools." World Bank, Washington, DC.

World Bank. Forthcoming. "Albania Public Finance Review, Part II: Improving the Efficiency and Quality of Public Spending." World Bank, Washington, DC.

Shtojcë

Tabela A.1. Aksesit në burime shkollore sipas grupeve socio-ekonomike

	20% i poshtëm i SESK	20% i sipërm i SESK	Total
Statusi socio-ekonomik (Indeks)	-2.38	0.56	-0.95
Praktikat e mësimdhënies (Indeks)	-0.61	-0.39	-0.53
Strategjitë e të mësuarit (Indeks)	-0.26	0.16	-0.08
Cilësia e burimeve arsimore (Indeks)	-1.11	-0.47	-0.74
Frekuentuar institucion parashkollor një vit (%)	21.6	20.0	22.7
Frekuentuar institucion parashkollor mbi një vit (%)	41.6	64.3	52.7
Mungesë e mësuesve të kualifikuar (%)	27.8	15.5	19.1
Mungesë kompjuterash (%)	58.4	37.7	44.6
Mungesë interneti (%)	83.0	47.6	63.3
Mungesë materialesh mësimore (%)	19.0	16.7	17.6
Rezultati PVNN në lexim	346	439	385
Rezultati PVNN në matematikë	343	421	377
Rezultati PVNN në shkencë	357	436	391

Burimi: PVNN 2009.

Shënim: Indeksi i praktikave të mësimdhënies dhe strategjive të të mësuarit janë normalizuar në nivelin e OBZHE-së. Indeksi socio-ekonomik ka një mesatare të kampionit të plotë prej -0.55 dhe një devijim standard prej 1.21. Indeksi i cilësisë së burimeve arsimore ka një mesatare të kampionit të plotë prej -0.28 dhe një devijim standard prej 1.21.

Tabela A.2. Aksesit në burime shkollore sipas vendbanimit urban/rural

	Urban	Rural	Total
Statusi socio-ekonomik (Indeks)	-0.59	-1.40	-0.95
Praktikat e mësimdhënies (Indeks)	-0.45	-0.63	-0.53
Strategjitë e të mësuarit (Indeks)	0.00	-0.19	-0.08
Cilësia e burimeve arsimore (Indeks)	-0.45	-1.11	-0.74
Frekuentuar institucion parashkollor një vit (%)	23.1	22.2	22.7
Frekuentuar institucion parashkollor mbi një vit (%)	56.1	48.4	52.7
Mungesë e mësuesve të kualifikuar (%)	14.5	24.7	19.1
Mungesë kompjuterash (%)	35.8	55.2	44.6
Mungesë interneti (%)	41.8	89.2	63.3
Mungesë materialesh mësimore (%)	21.2	13.3	17.6
Rezultati në lexim	409	355	385
Rezultati në matematikë	397	354	377
Rezultati në shkencë	408	369	391

Burimi: PVNN 2009.

Shënim: Indeksi i praktikave të mësimdhënies dhe strategjive të të mësuarit janë normalizuar në nivelin e OBZHE-së. Indeksi socio-ekonomik ka një mesatare të kampionit të plotë prej -0.55 dhe një devijim standard prej 1.21. Indeksi i cilësisë së burimeve arsimore ka një mesatare të kampionit të plotë prej -0.28 dhe një devijim standard prej 1.21.

Tabela A.3. Indekset e strategjive të të mësuarit dhe praktikave të mësimitdhënies

Strategjitë e të mësuarit	Kontrolli	Si vendosin nxënësit objektivave të qarta për veten dhe si e monitorojnë progresin e tyre në arritjen e tyre
	Memorizimi	Shkalla në të cilën nxënësit përpiqen të memorizojnë tekstet
	Përpunimi	Si i lidhin nxënësit njohuritë e fituara me kontekste të tjera (jetën e tyre, jashtë shkollës dhe njohuri të mëparëshme)
	Njohja e aftësive njohëse: të kuptuarit dhe të mbajturit mend	Krahason strategjitë e nxënësve për të kuptuar dhe mbajtur mend me ato që ekspertët vlerësojnë si strategjitë më të përshtatshme
	Njohja e aftësive njohëse: përmbledhja	Krahason strategjitë e nxënësve për të bërë përmbledhje me atë ato që ekspertët vlerësojnë si strategjitë më të përshtatshme
Praktikat e mësimitdhënies	Disiplina, rendi dhe menaxhimi i kohës	Klima disiplinore në klasë (zhurma dhe sa kohë duhet që nxënësit të qetësohen/pushojnë)
	Diskutime dhe debate	Shkalla në të cilën mësuesit i angazhojnë nxënësit në diskutime
	Lidhja e njohurive	A përpiqen mësuesit të ndihmojnë nxënësit të bëjnë lidhjen e njohurive me kontekste të ndryshme (njohuri të mëparëshme dhe përvoja personale)
	Qartësimi i pritshmërive	A e përshkruajnë mësuesit që nga fillimi se si do të jetë ndërveprimi nxënës-mësues
	Menaxhimi i detyrave	A vënë mësuesit nota për detyrat, a kontrollojnë për të parë nëse nxënësit e kanë kuptuar mësimin dhe a i motivojnë nxënësit
Cilësia e materialeve arsimore	Mungesë apo pamjaftueshmëri e faktorëve të mëposhtëm (sipas informimit nga drejtorët e shkollave)	Pajisje për laboratorin e shkencave, materiale mësimore (duke përfshirë tekstet shkollore), kompjutera për mësimitdhënie, lidhje me internetin, programe kompjuterike për mësimitdhënie, materiale biblioteke dhe burime audio-vizuale

Burimi: Shihni OBZHE (2012b) për më shumë hollësi mbi indekset.

Shënim: Indekset janë krijuar nga autorët duke përdorur koeficientët e gjetur në regresin linear të rezultateve të leximit që janë përfshirë në të dhënat e grumbulluara për të gjitha vendet pjesëmarrëse në PVNN 2009.

Tabela A.4. Regresion OLS të rezultateve PVNN për leximin

VARIABLAT	Shqipëria	Kampioni i plotë
Femër	42.79*** (3.433)	19.36*** (0.62)
Mosha	-14.31** (6.266)	-4.492*** (0.972)
Klasa	0.705 (6.203)	22.05*** (0.831)
Fillimi	-8.545** (3.849)	0.611 (0.569)
SESK	13.06*** (1.577)	8.801*** (0.324)
ASESK	28.67*** (6.32)	31.06*** (1.041)
Indeksi i praktikave të mësimdhënies	10.39*** (1.9)	11.71*** (0.306)
Indeksi i strategjive të të mësuarit	28.31*** (1.894)	29.28*** (0.379)
Raportet nxënës-mësues	0.858 (0.535)	0.0229 (0.0584)
Indeksi i cilësisë së burimeve arsimore	6.91 (4.242)	0.735 (0.619)
Frekuentuar mbi një vit arsim parashkollor	6.071 (3.795)	4.623*** (0.726)
Përqindja e mësuesve me arsim të lartë	27.92** (12.8)	6.013* (3.29)
Konstante	676.1*** (94.08)	548.2*** (14.91)
Country Dummies	No	Yes
Vëzhgime	2,812	355,121
R ²	0.429	0.582

Robust standard errors në kllapa

*** p<0.01, ** p<0.05, * p<0.1

Shënim: Gabime të grumbulluara në nivel shkolle.

Tabela A.5. Zbërthimi Oaxaca-Blinder i diferencës së performancës në lidhje me qytetet, PVNN 2009

VARIABLAT	Qytet	Qytet i vogël	Fshat
Qytet i madh	438.8*** (7.672)	438.8*** (7.956)	438.8*** (7.882)
Vendndodhje me interes	364.0*** (7.810)	386.8*** (6.245)	411.9*** (6.999)
Diferenca	74.72*** (10.95)	51.98*** (10.11)	26.84** (10.54)
Efikasitet sistemik	6.036 (11.16)	14.62 (10.42)	6.400 (6.857)
Shpjeguar	68.68*** (12.63)	37.36*** (11.62)	20.44** (9.366)
Vajzë	-2.114 (1.331)	-3.288** (1.380)	-1.601 (1.575)
Fillim	-0.540 (0.839)	-1.102 (0.977)	-1.642 (1.065)
Mosha	1.252 (0.904)	1.513 (1.006)	1.248 (0.896)
Klasa	-0.0250 (0.321)	-2.947 (2.290)	-0.880 (2.161)
SESK	15.31*** (2.944)	8.501*** (1.950)	4.665*** (1.584)
SESK (shkollë)	42.39*** (10.28)	25.48*** (7.471)	15.70*** (5.335)
Praktikë mësimdhënieje (Indeks)	2.112** (0.902)	1.964*** (0.751)	1.719** (0.781)
Strategjitë e të mësuarit (Indeks)	7.355*** (2.666)	5.914** (2.623)	1.949 (2.394)
Cilësia e burimeve shkollore (Indeks)	4.270 (4.874)	1.938 (3.083)	0.0626 (1.607)
Cilësia e burimeve shkollore ² (Indeks)	-1.329 (3.386)	-0.614 (1.098)	-0.778 (2.010)
Konstante	-146.3 (254.5)	90.58 (234.2)	402.2* (224.0)
Observations	1,655	1,597	1,878

Shënim: Gabimi standard në kllapa. Zbërthim i dyfishtë Oaxaca. Efikasiteti i sistemit shpjegon agregimin returns to endoements dhe pjesën e pashpjeguar të zbërthimit Oaxaca. Fshatrat janë vendbanime me më pak se 3, 000 banorë; qytetet e vogla kanë ndërmjet 3, 000 dhe 15, 000 banorë; qytetet kanë ndërmjet 15, 000 dhe 100,000 banorë; dhe qytetet kanë ndërmjet 100, 000 dhe 1, 000, 000 banorë.

Tabela A.6. Zbërthimi Oaxaca-Blinder i diferencave gjinore në lexim, PVNN 2009

VARIABLAT	E përgjithshme	Karakteristikat	Koefiçentë
Vajza	431.1*** (4.549)		
Djem	379.0*** (5.758)		
Diferenca	52.05*** (4.586)		
Karakteristikat	10.35*** (3.329)		
Koefiçentë	42.57*** (3.519)		
E pashpjeguar	-0.859 (1.816)		
Fillimi		1.545* (0.801)	50.28 (46.62)
Mosha		0.0209 (0.0896)	-379.0* (228.5)
Klasa		-0.373 (0.777)	6.549* (3.638)
SESK		-0.599 (0.582)	-5.106 (3.133)
SESK (shkollë)		-0.191 (1.250)	6.491 (7.223)
Praktikat e mësimdhënies		1.462** (0.674)	1.958 (1.931)
Strategjitë e të mësuarit		8.551*** (1.528)	0.969 (0.664)
Raporti nxënës-mësues		0.0311 (0.213)	23.63** (11.27)
Cilësia e burimeve arsimore (Indeks)		-0.844 (0.830)	2.565 (3.650)
Frektuentuar të paktën dy vjet arsim parashkollor		0.746 (0.601)	-0.852 (2.755)
Konstante			335.0 (216.7)
Vëzhgime	2,903	2,903	2,903

Shënim: Gabimi standard në kllapa. Zbërthim i trefishtë Oaxaca.